



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 221

Tiranë – E enjte, 24 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1001, datë 2.12.2015	Për integrimin e Spitalit Universitar të Traumës dhe Spitalit Ushtarak të Forcave të Armatosura në një strukturë të bashkuar..... 14485
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1003, datë 9.12.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-Pass Vlorë (shtesa)” 14486
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1005, datë 9.12.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Maminas-Gjiri i Lalëzit” 14487
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1006, datë 16.12.2015	Për lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 122 veprave artistike, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, për realizimin e ekspozitës “Realizmi Socialist Shqiptar në GKK”, që do të zhvillohet përgjatë muajve dhjetor 2015 – janar 2016, në Galerinë Kombëtare Kosovës..... 14488
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1011, datë 16.12.2015	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj. Elena Kadare.... 14493
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1012, datë 16.12.2015	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Moikom Zeqo..... 14493
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 16.12.2015	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Isa Tare..... 14493
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1014, datë 16.12.2015	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Nestor Jonuzi..... 14494
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1015, datë 16.12.2015	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Kristaq Leno..... 14494
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1016, datë 16.12.2015	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Kujtim Kasmi..... 14494

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1017, datë 16.12.2015	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Koço Çomi.....	14494
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1018, datë 16.12.2015	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Neptun Bajko.....	14495
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1019, datë 16.12.2015	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Aziz Tahiri.....	14495
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1020, datë 16.12.2015	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Hektor Dule.....	14495
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1021, datë 16.12.2015	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Kreshnik Tartari..	14495
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1022, datë 16.12.2015	Për lejimin e përdorimit të fondit të pagave për shpërblimin e disa punonjësve të Policisë së Shtetit.....	14496
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1023, datë 16.12.2015	Për nënsektorët strategjikë dhe zonat me përparësi zhvillimi.....	14496
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1024, datë 16.12.2015	Për miratimin e projekteve me statusin “Projekt me potencial strategjik”.....	14498
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1025, datë 16.12.2015	Për shërbimet e promovimit dhe përfaqësimit të investimeve strategjike.....	14501
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1026, datë 16.12.2015	Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike.....	14502
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1027, datë 16.12.2015	Për tarifën e shërbimeve për investimet strategjike.....	14504
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1028, datë 16.12.2015	Për përcaktimin e marzheve, rregullave dhe dokumentacionit të garancive financiare të investimeve strategjike.....	14506
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1029, datë 16.12.2015	Për bashkëpunimin ndërinstitucional në procedurat e investimeve strategjike.....	14508
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1030, datë 16.12.2015	Për organizimin dhe formën e pjesëmarrjes së shtetit në investimet strategjike dhe rregullat për krijimin, funksionimin e administrimin e fondit të pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike.....	14510
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1031, datë 16.12.2015	Për përcaktimin e rregullave për funksionimin, krijimin, administrimin dhe për formatin, përmbajtjen e procedurat për sigurinë e Regjistrisë të Investimeve Strategjike.....	14514
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1032, datë 16.12.2015	Për dokumentimin e marrëveshjeve të investitorëve strategjikë me pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private.....	14516
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1033, datë 16.12.2015	Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, që do t'u paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet.....	14518

**VENDIM****Nr. 1001, datë 2.12.2015****PËR INTEGRIMIN E SPITALIT
UNIVERSITAR TË TRAUMËS DHE
SPITALIT USHTARAK TË FORCAVE TË
ARMATOSURA NË NJË STRUKTURË TË
BASHKUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 147/2014, “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe të ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Spitali Ushtarak i Forcave të Armatosura transformohet në Njësinë e Mjekësisë Ushtarake (NJMU), pranë Spitalit Universitar të Traumës Tiranë (SUT).

2. Spitali Universitar i Traumës dhe Njësia e Mjekësisë Ushtarake integrohen në kuadër të një strukture të bashkuar spitalore, me emërtimin Spitali Universitar i Traumës.

3. Spitali Universitar i Traumës është person juridik, publik, buxhetor, në varësi administrative të Ministrisë së Shëndetësisë. Spitali Universitar i Traumës është pjesë e rrjetit të integruar të shërbimit mësimor e kërkimor-shkencor dhe spitalor në Republikën e Shqipërisë dhe ndjek e zbaton aktet ligjore e nënlige në fushën e shëndetësisë.

4. Spitali Universitar i Traumës shërben si Qendër Kombëtare e Traumës me funksion mjekësor, mësimor e kërkimor-shkencor dhe ka këto përgjegjësi kryesore:

a) Ofrimin e shërbimit të urgjencës mjekësore në nivelin më të lartë të saj në rang kombëtar;

b) Përkujdesjen shëndetësore për personelin e Forcave të Armatosura që ka statusin e ushtarakut;

c) Dhënien e kontributit me kapacitete shëndetësore në përgjigje të detyrimeve të Shqipërisë, si vend anëtar në NATO.

ç) Ofrimin e veprimtarisë akademike, mësimore e kërkimore-shkencore në funksion të realizimit të procesit mësimor dhe kërkimor në fushën e shëndetësisë.

5. Struktura organike e integruar e Spitalit Universitar të Traumës hartohet nga ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Mbrojtjes, sipas përgjegjësi specifike, dhe miratohet nga Kryeministri.

6. Në strukturën organike të integruar të Spitalit Universitar të Traumës parashikohen funksione për personel civil dhe për personel ushtarak. Personeli civil është nën përgjegjësinë e planifikimit dhe të menaxhimit të ministrit të Shëndetësisë. Personeli ushtarak është nën përgjegjësinë e planifikimit dhe të menaxhimit të Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Drejtori dhe nëndrejtori civil i Spitalit Universitar të Traumës emërohen nga ministri i Shëndetësisë.

8. Shefi i Njesisë së Mjekësisë Ushtarake është njëkohësisht edhe nëndrejtor ushtarak i Spitalit Universitar të Traumës. Nëndrejtori ushtarak i Spitalit Universitar të Traumës emërohet nga ministri i Mbrojtjes.

9. Personeli tjetër mjekësor dhe administrativ i Spitalit Universitar të Traumës emërohet sipas kuadrit ligjor dhe nënlige në fuqi.

10. Planifikimi buxhetor për funksionimin normal të Spitalit Universitar të Traumës kryhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mbrojtjes, sipas përgjegjësi përkatëse.

11. Ministria e Mbrojtjes bën planifikimin buxhetor të NJMU-së, ku parashikohen shpenzimet për personelin ushtarak të Spitalit Universitar të Traumës e për përkujdesjen shëndetësore ndaj personelit me statusin e ushtarakut, si dhe përbashkimi i shpenzimeve në kuadër të detyrimeve të vendit në NATO.

12. Ministria e Mbrojtjes vë në dispozicion fondin e akorduar për Spitalin Universitar të Traumës, në bazë të rregullave specifike të miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit të Shëndetësisë.

13. Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për drejtimin, menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të Spitalit Universitar të Traumës në të gjitha aspektet.



14. Ministria e Mbrojtjes ka të drejtë të thërrasë në çdo kohë personelin ushtarak të Spitalit Universitar të Traumës në interes të stërvitjeve me rëndësi të veçantë, të përballimit të emergjencave civile dhe të angazhimit në operacione ushtarake brenda dhe jashtë vendit. Personeli ushtarak i thirrur në detyrë nga Ministria e Mbrojtjes vijon të përfitojë të gjithë trajtimin ekonomik e financiar edhe gjatë periudhës së detyrës ushtarake.

15. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mbrojtjes për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1003, datë 9.12.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “BY-PASSVLORË (SHTESA)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-Pass Vlorë, (shtesa)”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “objekt”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 9 832 636 (nëntë milionë e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, nga të cilat:

- për pasurinë “truall”, me sipërfaqe shpronësimi 180 (njëqind e tetëdhjetë) m², me vlerën 1 494 000 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë;

- për pasurinë “objekt”, me sipërfaqe 149 (njëqind e dyzet e nëntë) m², me vlerën 8 338 636 (tetë milionë e treqind e tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.

4. Vlera përgjithshme e shpronësimit, prej 9 832 636 (nëntë milionë e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësime, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, “Vërtetim hipotekor”, “Certifikatë pronësie”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 e 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti



Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONAREVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“BY PASS-VLORË (SHITESA)”

Nr.	PRONARI			Z. kad.	Nr. i pasurisë	Sip. përgj.	Truall	Objekt	Çmimi lekë/m ²	Vlera totale në lekë	Konfirmimi
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	B/P HARUNI			8605	6/257	180	180		8300	1494000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	BARDHYL HARUNI			8605	6/257-ND	149		149	55964	8338636	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
TOTALI										9832636	

VENDIM

Nr. 1005, datë 9.12.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR “MAMINAS-GJIRI
I LALËZIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Maminas-Gjiri i Lalëzit”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “objekte”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 6 684 254 (gjashtë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e

katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 6 684 254 (gjashtë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësime”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, “Vërtetim hipotekor”, “Certifikatë pronësie”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 e 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor



Shqiptar, dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE TË OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “MAMINAS-GJIRI I LALËZIT”

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Nr. i Z. Kad.	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe ndërtimi	Lloji i objektit	Vlera (lekë)	Shënime
1	Sefer Luku	2590	443/20	72 m ²	Ndërtesë	1 826 451	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Hasan Zenel Sallaku	3137	62/11	72 m ²	Objekt banimi	2 515 944	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Kalem Sallaku	3137	63/8		Mur rrethues	403 205	Leje ndërtimi
4	Naim Gjergji	2065	38/33	30 m ²	Ndërtesë	1 338 945	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Rustem Hoxha	3137	62/9		Mur rrethues	599 708,7	Leje ndërtimi
	SHUMA TOTALE					6,684,254	

VENDIM

Nr. 1006, datë 16.12.2015

**PËR LEJIMIN E LËVIZJES JASHTË
TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË TË 122 VEPRAVE
ARTISTIKE, PJESË E FONDIT TË
GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE,
PËR REALIZIMIN E EKSPOZITËS
“REALIZMI SOCIALIST SHQIPTAR NË
GKK”, QË DO TË ZHVILLOHET
PËRGJATË MUAJVE DHJETOR 2015 –
JANAR 2016, NË GALERINË
KOMBËTARE KOSOVËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e lëvizjes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 122 (njëqind e njëzet e

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

dy) veprave artistike, objekte të rralla me vlera unikalë, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, për realizimin e ekspozitës “Realizmi Socialist Shqiptar në GKK”, që do të zhvillohet përgjatë muajve dhjetor 2015 – janar 2016 në Galerinë Kombëtare të Kosovës, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Lejimi i lëvizjes së veprave bëhet për periudhën 15 dhjetor 2015 deri më 1 shkurt 2016.

3. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 18.3.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unikalë, për restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

4. Ngarkohen Galeria Kombëtare e Arteve të kryejë shoqërimin dhe kthimin e veprave në vendin e origjinës, pas mbarimit të veprimtarisë, dhe Qendra e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e lëvizjes së objekteve.

5. Ngarkohet ministri i Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja 1

NR.	KODI QKIPK	NR. INV	AUTORI KODI I AUTORIT	POSEDUES KODI I POSEDUESIT 005	TITULLI I VEPRËS	Vlera
1	6017	1928	Bujar ZAJMI (495)	GKA	BAJRAM CURRI 1977	80.000 lekë
2	5127	1437	Musa QARRI (268)	GKA	DRUVARI 1973	80.000 lekë
3	4756	2438	Pandi MELE (423)	GKA	VAJZA E BREZAREVE, 1981	50.000 lekë
4	24867	1138	Pandi MELE (423)	GKA	TEKSTILISTJA 1971	80.000 lekë
5	24894	126/2	Pandi MELE (423)	GKA	SHOKËT (Cikël me 4 punime) 1971	80.000 lekë
6	24904	2740	Pandi MELE (423)	GKA	DARDHARJA, 1983	50.000 lekë
7	4760	3770	Pandi MELE (423)	GKA	MBJELLËSE, 1988	80.000 lekë
8	24146	1666	Safo MARKO (303)	GKA	HEROINA E POPULLIT SHOTE QERIME GALICA, 1974	50.000 lekë
9	24140	1508	Safo MARKO (303)	GKA	USHTARAKJA, 1973	80.000 lekë
10	24142	1479	Safo MARKO (303)	GKA	FINADËT, 1973	80.000 lekë
11	4039	1711	Abdulla CANGONJI (011)	GKA	DURRËSI - PORTI I MIQËSISË, 1975	100.000 lekë
12	3748	938	Abdurrahim BUZA (001)	GKA	NË DITËT E LUFTËS PARTIZANE, 1969	200.000 lekë
13	3740	777	Abdurrahim BUZA (001)	GKA	PUNA VULLNETARE NË KOMBINATIN E TEKSTILEVE "STALIN", 1948	200.000 lekë
14	6048	1018	Agim ZAJMI (020)	GKA	LAÇI INDUSTRIAL, 1969	100.000 lekë
15	6058	1834	Agim ZAJMI (020)	GKA	BUJQËSIA-ÇËSHITJE E TË GJITHËVE, 1976	150.000 lekë
16	4883	937	Aristotel PAPA (044)	GKA	NGA NDËRTIMET, 1969	100.000 lekë
17	4881	929	Aristotel PAPA (044)	GKA	AZOTIKU FIER, 1969	150.000 lekë
18	24305	973	Bajram MATA (954)	GKA	AKSIONISTET, 1969	100.000 lekë
19	4340	1499	Bardhyl DULE (056)	GKA	KORRIERI PARTIZAN, 1973	100.000 lekë
20	23005	309	Bukurosh SEJDINI (496)	GKA	AGIMI I 17 NËNTORIT 1944 NË TIRANË, 1957	350.000 lekë
21	5571	769	Bukurosh SEJDINI (496)	GKA	TARRACAT E FËMIJËVE, 1966	150.000 lekë
22	3975	2257	Çlirim CEKA (431)	GKA	30 KORRIK 1978, 1979	200.000 lekë
23	25290	1450	Danish JUKNIU (074)	GKA	PORTRET VAJZE, 1973	100.000 lekë
24	25293	1922	Danish JUKNIU (074)	GKA	PARTIZANI, 1968	200.000 lekë



25	26622	3863	Dashmir MYFTARI (951)	GKA	MINATORI, 1989 (BLERJA)	80.000 lekë
26	5726	1988	Dhimitraq TREBICKA (081)	GKA	DOLLIA E PARË PËR PARTINË, 1977	200.000 lekë
27	4580	1154	Edison GJERGO (516)	GKA	FONDITORI, 1971	150.000 lekë
28	5281	1956	Foto STAMO (112)	GKA	NË LËMË, 1977	100.000 lekë
29	5386	1919	Foto STAMO (112)	GKA	NJËSITI LUFTARAK NË SHËRBIM, 1975	100.000 lekë
30	23573	557	Guri MADHI (129)	GKA	PORTRET PUNËTORI, 1961	200.000 lekë
31	24095	2212	Hasan KOKA (519)	GKA	ÇLIRIMTARËT, 1979	100.000 lekë
32	25993	2850	Hasan NALLBANI (146)	GKA	PAMJE NGA KOMBINATI METALURGJIK, 1984	100.000 lekë
33	3604	1729	Hiqmet AGOLLI (153)	GKA	AKSIONISTJA, 1974	100.000 lekë
34	3603	1816	Hiqmet AGOLLI (153)	GKA	OXHAQET QË PUSHUAN QIELLIN, 1976	100.000 lekë
35	24601	932	Ismail LULANI (177)	GKA	NË HIDROCENTRALIN E VAUT TË DEJËS, 1969	100.000 lekë
36	25565	1618	Ismail LULANI (177)	GKA	SHOTE GALICA	350.000 lekë
37	25918	1984	Ismail LULANI (177)	GKA	BARESHA DELEGATE, 1977	150.000 lekë
38	5578	1245	Isuf SULOVARI (595)	GKA	PUSHIM PARTIZAN, 1971	250.000 lekë
39	5590	808	Isuf SULOVARI (595)	GKA	AKSIONISTJA, 1967	100.000 lekë
40	5588	1767	Isuf SULOVARI (595)	GKA	GJIGANDI I METALURGJISË, 1974	200.000 lekë
41	26236	2784	Jakup KERRAJ (184)	GKA	MJELËSJA, 1960	150.000 lekë
42	4367	1815	Muhamet DELIU (262)	GKA	MBRËMJE NË KOOPERATIVË, 1976	150.000 lekë
43	4365	2380	Muhamet DELIU (262)	GKA	ME FORCAT TONA, 1980	100.000 lekë
44	4753	1841	Pandi MELE (423)	GKA	JU FLET TIRANA, 1976	150.000 lekë
45	4762	2379	Pandi MELE (423)	GKA	NOVATORËT, 1980	150.000 lekë
46	24905	2977	Pandi MELE (423)	GKA	DITARI PARTIZAN, 1984	150.000 lekë
47	24902	2228	Pandi MELE (423)	GKA	SHPËRTHIMI, 1979	100.000 lekë
48	25115	1212	Petro KOKUSHTA (1063)	GKA	NË SHTËPINË E PARTISË, 1971	150.000 lekë
49	4174	3645	Rafaël DEMBO (314)	GKA	SHKOJMË NË PUNË	100.000 lekë
50	24667	2232	Ramadan KARANXHA (726)	GKA	KRIPORJA, 1979	100.000 lekë
51	5053	736	Sali SHIJAKU (331)	GKA	AKSIONISTI, 1966	150.000 lekë



52	5459	1512	Sali SHIJAKU (331)	GKA	NËNAT, 1973	250.000 lekë
53	5391	1783	Sali SHIJAKU (331)	GKA	MIC SOKOLI, 1976	350.000 lekë
54	5464	741	Sali SHIJAKU (331)	GKA	PARAROJA E BATALIONIT “HAKMARRJA”, 1966	200.000 lekë
55	5389	2050	Sali SHIJAKU (331)	GKA	ILIA KICI DASHI, 1978	150.000 lekë
56	3614	1779	Shpëtim ARAPI (344)	GKA	DREJT LARTËSIVE, 1976	100.000 lekë
57	5156	1740	Simon RROTA (346)	GKA	PORTRET I RROBAQEPËSES, 1929	150.000 lekë
58	3426	862	Skënder KAMBERI (777)	GKA	BE'TIMI I VRANA KONTTI, 1968	300.000 lekë
59	3990	1115	Sotir CAPO (356)	GKA	AKSIONISTJA, 1970	100.000 lekë
60	3991	902	Sotir CAPO (356)	GKA	PRODHUESJA E TELAVE ELEKTRIKE, 1969	150.000 lekë
61	24912	1142	Spiro KRISTO (795)	GKA	TEKSTILISTJA, 1971	100.000 lekë
62	71916	4533	Spiro KRISTO (795)	GKA	DITË FLUTURIMI, 1968	700.000 lekë
63	5843	484	Vangjush TUSHI (388)	GKA	KOOPERATIVISTI, 1959	150.000 lekë
64	25573	1698	Vilson HALIMI (394)	GKA	PORTRET MARINARA, 1975	150.000 lekë
65	25563	1600	Vilson HALIMI (394)	GKA	SHOKË LUFTE, SHOKË JETE, 1974	150.000 lekë
66	25623	1893	Vilson HALIMI (394)	GKA	KUDO JEMI NË BALLË, 1976	150.000 lekë
67	25257	2795	Vilson KILICA (395)	GKA	NDËRTUESIT, 1983	150.000 lekë
68	3402	2833	Vilson KILICA (395)	GKA	NAFTËTARI, 1983	150.000 lekë
69	5478	2553	Zef SHOSHI (407)	GKA	HIDROCENTRALI I FIERZËS, 1979	150.000 lekë
70	3425	905	Zef SHOSHI (407)	GKA	TORNITORJA, 1969	150.000 lekë
71	5353	2624	Besim TULA (492)	GKA	PLLAKAT I 70 VJETORIT TË PAVARËSISË, 1982	50.000 lekë
72	3831	3482	Fatmir BIBA (536)	GKA	PLLAKAT – ASGJË TJETËR MBI KRYE VEÇ FLAMURIT TË MARKSIZËM-LENINIZMIT, 1986	80.000 lekë
73	3556	1667	Franc ASHIKU (113)	GKA	PLLAKAT – LIRI A VDEKJE!, 1974	50.000 lekë
74	3526	1935	Franc ASHIKU (113)	GKA	PLLAKAT – SIGURIMI I BUKËS NË VEND, 1977	50.000 lekë
75	3522	2275	Franc ASHIKU (113)	GKA	PLLAKAT – JOSIF V. STALIN, 1979	50.000 lekë
76	5563	971	Kostandin S'TAVRE (618)	GKA	PLLAKAT – SODA KAUSTIKE VLORË, 1969	50.000 lekë
77	4085	850	Ksenofon DILO (221)	GKA	PLLAKAT – ELEKTRIFIKIMI, 1968	50.000 lekë
78	25590	1745	Petrit KUMI (1069)	GKA	PLLAKAT - 30 VJET ÇLIRIM, 1974	50.000 lekë
79	4504	1247/1	Dhimo GOGOLLARI (881)	GKA	KOOPERATIVISTJA NGA TARAZHI	200.000 lekë
80	4164	2381	Fuat DUSHKU (099)	GKA	PORTRET NAFTËTARI	200.000 lekë
81	5891	1040/6	Gori VERRIA (562)	GKA	ZADRIMORJA	250.000 lekë



82	26985	1040/4	Halim BEQIRAJ (138)	GKA	BUSTI I LABIT	250.000 lekë
83	4219	763/1	Hektor DULE (151)	GKA	NË NJËRËN DORË KAZMËN, NË TJETRËN PUSHKËN	300.000 lekë
84	4192	3340	Hektor DULE (151)	GKA	GURI RËNDË NË VEND TË VET	350.000 lekë
85	4207	2932	Hektor DULE (151)	GKA	UDHËVE TË JETËS, 1984	300.000 lekë
86	27305	3337	Janaq PAÇO (186)	GKA	KOKË USHTARI, 1973	350.000 lekë
87	4300	763/5	Muntaz DHRAMI (266)	GKA	FONDITORI,	250.000 lekë
88	4256	2711/1	Muntaz DHRAMI (266)	GKA	VAJZA ME KORDELE	150.000 lekë
89	3656	755	Abdurrahim BUZA (001)	GKA	RRUGA E DRITËS- HIDROCENTRALI “KARL MARKS”, _____	80.000 lekë
90	3660	1477	Abdurrahim BUZA (001)	GKA	NË SHITIGJEN, _____	80.000 lekë
91	4335	673	Bardhyl DULE (056)	GKA	PRANVERË, TIRANA, 1964	50.000 lekë
92	6016	1324	Bujar ZAJMI (495)	GKA	NUSJA NGA SHPATI, 1970	80.000 lekë
93	5735	2776	Dhimitraq TREBICKA (081)	GKA	MOTIVE NGA FESTIVALI, 1978	50.000 lekë
94	5278	3545	Foto STAMO (112)	GKA	RIZA KODHELI-VETERAN I LANÇ, 1958	80.000 lekë
95	26543	3621/1	Gazmend LEKA (116)	GKA	TREGIME TË MOÇME SHQIPTARE (CIKËL ME 27 COPË), 1987, ROZAFATI	50.000 lekë
96	26544	3621/2	Gazmend LEKA (116)	GKA	BESA E KOSTANDINIT	
97	26545	3621/3	Gazmend LEKA (116)	GKA	KËNGA E DHOQINËS	
98	26544	3621/4	Gazmend LEKA (116)	GKA	GJERGJ ELEZ ALIA	
99	26547	3621/5	Gazmend LEKA (116)	GKA	KOSTANDINI I VOGËLTH	
100	26548	3621/6	Gazmend LEKA (116)	GKA	YMER AGË ULQINI	
101	26549	3621/7	Gazmend LEKA (116)	GKA	OMERI I RI	
102	26550	3621/8	Gazmend LEKA (116)	GKA	BIJA E HËNËS DHE E DIELLIT	
103	26577	3621/9	Gazmend LEKA (116)	GKA	FUQIA E MUJIT	
104	26578	3621/10	Gazmend LEKA (116)	GKA	ORËT E MUJIT	
105	26579	3621/11	Gazmend LEKA (116)	GKA	MUJI DHE ZANAT	
106	26580	3621/12	Gazmend LEKA (116)	GKA	MUJI DHE BEHURI	
107	26581	3621/13	Gazmend LEKA (116)	GKA	VDEKJA E OMERIT	
108	26582	3621/14	Gazmend LEKA (116)	GKA	AJKUNA QAN OMERIN	
109	26583	3621/15	Gazmend LEKA (116)	GKA	MUJI DHE HALILI TEK MBRETI	
110	26542	3621/16	Gazmend LEKA	GKA	HALILI PAS VDEKJES	
111	26541	3621/17	Gazmend LEKA (116)	GKA	ARNAUT OSMANI E HYSA BADOICA	



112	26540	3621/18	Gazmend LEKA (116)	GKA	DASMA E HYSEN KRAPOSHNIKUT	
113	26539	3621/19	Gazmend LEKA (116)	GKA	DEDË SKURA	
114	26538	3621/20	Gazmend LEKA (116)	GKA	E SHOQJA E PJETËR SHINIT	
115	26537	3621/21	Gazmend LEKA (116)	GKA	VASHA DHE TRIMI	
116	26536	3621/22	Gazmend LEKA (116)	GKA	ZONJA RINË ARBËRESHA	
117	26535	3621/23	Gazmend LEKA (116)	GKA	TURKU RRËMBEN NJË ARBËRE	
118	26534	3621/24	Gazmend LEKA (116)	GKA	RINA E RADHAVANI	
119	26533	3621/25	Gazmend LEKA (116)	GKA	MILO SHINI DHE ALI BEGU	
120	26532	3621/26	Gazmend LEKA (116)	GKA	SKËNDERBEU DHE BALLABANI	
121	26531	3621/27	Gazmend LEKA (116)	GKA	SKËNDERBEU DHE MILOSHINI	
122	26617	3785	Zamfira HETA (1124)	GKA	NË ATELIENË E SHKOLLËS, 1988	50.000 lekë

VENDIM**Nr. 1011, datë 16.12.2015****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR ZNJ. ELENA KADARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj. Elena Kadare, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 1012, datë 16.12.2015****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. MOIKOM ZEZO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Moikom Zeqo, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 1013, datë 16.12.2015****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. ISA TARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Isa Tare, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 1014, datë 16.12.2015****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. NESTOR
JONUZI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Nestor Jonuzi, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 1015, datë 16.12.2015****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. KRISTAQ
LENO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Kristaq Leno, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 1016, datë 16.12.2015****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. KUJTIM
KASMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Kujtim Kasmi, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 1017, datë 16.12.2015****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. KOÇO ÇOMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Koço Çomi, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM**

Nr. 1018, datë 16.12.2015

**PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. NEPTUN
BAJKO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Neptun Bajko, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1019, datë 16.12.2015

**PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. AZIZ
TAHIRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Aziz Tahiri, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1020, datë 16.12.2015

**PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. HEKTOR
DULE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Hektor Dule, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1021, datë 16.12.2015

**PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË
POSAÇËM SHTETËROR Z. KRESHNIK
TARTARI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Kreshnik Tartari, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM**

Nr. 1022, datë 16.12.2015

**PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË
FONDIT TË PAGAVE PËR
SHPËRBLIMIN E DISA PUNONJËSVE TË
POLICISË SË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 143, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Policisë së Shtetit për përdorimin e fondit prej 98 400 000 (nëntëdhjetë e tetë milionë e katërqind mijë) lekësh, nga fondi i pagave, të planifikuar për vitin 2015, në programin buxhetor “Policia e Shtetit”, për shpërblimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, që kanë arritur rezultate të larta në kryerjen e detyrës.

2. Masa e shpërblimit të jetë deri në 2 paga mujore.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Edi Rama**VENDIM**

Nr. 1023, datë 16.12.2015

**PËR NËNSEKTORËT STRATEGJIKË
DHE ZONAT ME PËRPARËSI
ZHVILLIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 7, të nenit 8, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. NËNSEKTORËT STRATEGJIKË**

1. Në zbatim të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, sektorë strategjikë janë sektorët ekonomikë, të cilët konsiderohen, nga shteti shqiptar, me potencial të

lartë për zhvillimin e ekonomisë së vendit.

2. Sektorë strategjikë të investimeve konsiderohen:

- a) Sektori energjetik dhe mineral;
- b) Sektori “Transport, infrastrukturë e komunikimeve elektronike dhe mbetjet urbane”;
- c) Sektori “Turizëm (strukturat turistike)”;
- ç) Sektori “Bujqësi (Ferma e madhe bujqësore) dhe peshkim”;
- d) Sektori “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”;
- dh) Zonat me përparësi zhvillimi.

3. Brenda sektorëve strategjikë, të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, përcaktohen dhe identifikohen nënsektorët specifikë, si më poshtë vijon:

a) Sektori strategjik energjetik dhe mineral, në të cilin:

i) nënsektori energjetik përfshin investimet strategjike në fushat e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike;

ii) nënsektori i hidrokarbureve përfshin investimet strategjike në fushat e kërkimit, zhvillimit, nxjerrjes, prodhimit, ndarjes, përpunimit, grumbullimit, transportimit e shpërndarjes së naftës bruto e nënprodukteve hidrokarbure, veprimtaritë në fushën e transmetimit, shpërndarjes, tregtimit, depozitimit, furnizimit, si dhe të atyre për ndërtimin e operimin e infrastrukturës së gazit natyror;

iii) nënsektori mineral përfshin investimet strategjike në fushat e kërkimit, zbulimit dhe shfrytëzimit të mjedisit mineral.

b) Sektori strategjik transport, infrastrukturë e komunikimeve elektronike dhe mbetjet urbane, në të cilin:

i) nënsektori i transportit detar përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, mirëmbajtjen, administrimin e porteve detare, zonave portuale dhe marinave, si dhe ofrimin e shërbimeve të transportit detar të mallrave dhe pasagjerëve;

ii) nënsektori i transportit ajror përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, mirëmbajtjen, administrimin e aeroporteve, si dhe ofrimin e shërbimeve të transportit ajror të mallrave dhe pasagjerëve;

iii) nënsektori i transportit hekurudhor përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, mirëmbajtjen, administrimin e



infrastrukturës hekurudhore, si dhe ofrimin e shërbimeve të transportit hekurudhor të mallrave dhe pasagjerëve;

iv) nënsektori i transportit rrugor përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, mirëmbajtjen, administrimin e rrugëve rajonale dhe kombëtare, si dhe ofrimin e shërbimeve të transportit rrugor të mallrave dhe pasagjerëve;

v) nënsektori i rrjeteve të transportit përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, mirëmbajtjen, administrimin e rrjeteve alternative të transportit, të tilla si tram, metro apo transporte alternative të ngjashme, si dhe ofrimin e shërbimeve të transportit të pasagjerëve në to;

vi) nënsektori i komunikimeve elektronike, përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, mirëmbajtjen, administrimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, si dhe ofrimin e shërbimeve të aksesit të këtyre rrjeteve për përdoruesit;

vii) nënsektori i mbetjeve urbane përfshin investimet strategjike në veprimtaritë në lidhje me menaxhimin e integruar të mbetjeve, përfshirë grumbullimin, transportin, rikuperimin, asgjësimin e mbetjeve, ndërtimin, rikualifikimin, administrimin dhe kujdesin për mbylljen e landfilleve;

viii) nënsektori i ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, rehabilitimin dhe/ose mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë, sistemit të kanalizimeve, si dhe të impianteve të ujërave të ndotura.

c) Sektori strategjik i turizmit, në të cilin nënsektori i strukturave turistike përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e strukturave turistike akomoduese, të konsideruara si sipërmarrje turistike, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit për turizmin.

c) Sektori strategjik i bujqësisë dhe peshkimit, në të cilin:

i) nënsektori i prodhimit bujqësor përfshin investimet strategjike që kanë si model feramat e mëdha bujqësore;

ii) nënsektori i infrastrukturës së blegtorisë përfshin investimet strategjike që krijojnë dhe administrojnë infrastrukturën e nevojshme për blegtorinë dhe ofrojnë shërbimet e lidhura me shpërndarjen e produkteve blegtorale;

iii) nënsektori i infrastrukturës së peshkimit përfshin investimet strategjike që kanë si objekt ndërtimin dhe administrimin e infrastrukturave të peshkimit dhe akuakulturës si edhe ofrimin e shërbimeve për shpërndarjen e produkteve të peshkimit.

d) Sektori strategjik i zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, në të cilin nënsektori i parqeve industriale/teknologjike përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e parqeve industriale/teknologjike e të inovacionit, si dhe pajisjen me infrastrukturën e nevojshme për prodhim, zhvillim industrial, tregtimin dhe ofrimin e shërbimeve të lidhura me veprimtaritë që ushtrohen brenda tyre.

II. ZONAT ME PËRPARËSI ZHVILLIMI

1. Në zbatim të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, zona me përparësi zhvillimi janë zonat rajonale dhe/ose lokale të qeverisjes vendore, që konsiderohen si zona të një rëndësie të veçantë, të cilat kanë nevojë për mbështetje të posaçme, me qëllim zhvillimin ekonomik, nxitjen e punësimit, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe shfrytëzimin me eficiencë të burimeve e infrastrukturave publike.

2. Zhvillimi i zonave me përparësi zhvillimi fokusohet, kryesisht, në:

a) orientimin e investimeve në zona të caktuara territoriale, me qëllim nxitjen e përqendrimit të llojeve të njëjta apo të ngjashme të industrive apo veprimtarive tregtare, në mënyrë që të përfitohet nga specializimi i punëkërkuësve, ekonomitë e shkallës dhe ndarja e kostove infrastrukturore. Për këtë qëllim do të përdoren mekanizma nxitës, të cilët synojnë rritjen e eficiencës së infrastrukturave ekzistuese apo në zhvillim, si edhe do të ndërmerren masa për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet industriale;

b) orientimin e investimeve në zona të caktuara territoriale, në të cilat ka nivele të larta papunësie dhe ku zhvillimi ekonomik është në nivele të pakënaqshme, krahasuar me rajone të tjera të vendit. Për këtë qëllim do të përdoren mekanizma nxitës, të cilët synojnë zhvillimin ekonomik, rritjen e mirëqenies së popullatës, rritjen e punësimit dhe formimin profesional, si dhe përmirësimin e infrastrukturave.



3. Kriteret ndihmëse për identifikimin e zonave me përparësi zhvillimi do të jenë:

a) studimi i vendndodhjes, përqendrimit, numrit dhe rëndësisë ekonomike të veprimtarive industriale dhe tregtare ekzistuese, me qëllim krijimin e sinergjive ekonomike ndërmjet tyre;

b) analiza e gjendjes së infrastrukturave ekzistuese apo në zhvillim;

c) niveli i papunësisë së zonës;

ç) të ardhurat ekonomike për banor si edhe kritere të tjera ndihmëse, sipas nevojave dhe strategjive publike;

d) realizimi i objektivave të mbrojtjes efektive mjedisore;

dh) shfrytëzimi me efektivitet i aftësive e kualifikimeve të veçanta të punëkërkuësve aktivë të zonës;

e) statistikave të zhvillimit ekonomik të zonës përkatëse, sipas studimeve të INSTAT-it apo enteve të tjera publike;

4. Propozimi për shpalljen e zonave me përparësi zhvillimi mund të bëhet nga ministrat e linjës, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Komiteti i Investimeve Strategjike.

5. Identifikimi, shpallja dhe përcaktimi i mënyrës dhe rregullave të funksionimit të zonave, të cilat do të konsiderohen me përparësi zhvillimi, kryhet rast pas rasti, nga Këshilli i Ministrave, me vendim të posaçëm.

III. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe ministritë përgjegjëse për verifikimin e përputhshmërisë së projekteve të investimeve me nënsektorët strategjikë, si dhe për hartimin e propozimeve për shpalljen e zonave me përparësi zhvillimi, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1024, datë 16.12.2015

PËR MIRATIMIN E PROJEKTEVE ME STATUSIN “PROJEKT ME POTENCIAL STRATEGJIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç”, të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. STATUSI I PROJEKTEVE ME POTENCIAL STRATEGJIK

1. Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, “projekt me potencial strategjik” konsiderohet një projekt i mundshëm i investimit me ndikim strategjik për zhvillimin e vendit dhe me interes publik, i cili klasifikohet si i tillë që nga momenti i nismës për të hartuar projektin nga promovuesi i projektit deri në momentin e përfitimit të statusit “Investim/investitor strategjik”.

2. Projektet, të cilat përfitojnë statusin “projekt me potencial strategjik”, mbështeten nëpërmjet zbatimit të procedurave të posaçme administrative favorizuese, lehtësuese apo përsheptuese, si dhe dhënies së asistencës e ofrimit të shërbimeve ndaj investitorëve.

3. Projektet me statusin “projekt me potencial strategjik” miratohen nga Komiteti i Investimeve Strategjike, pasi të jenë kryer procedurat dhe vlerësimet paraprake nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve.

II. PROCEDURAT ADMINISTRATIVE PËR PËRFTITIMIN E STATUSIT “PROJEKT ME POTENCIAL STRATEGJIK”

1. Aplikimi për përfitimin e statusit “projekt me potencial strategjik” është hapi fillestar i procedurave administrative për vlerësimin e investimeve strategjike. Ky status propozohet nga momenti i nismës për të hartuar projektin dhe, në rast se miratohet, zgjat deri në momentin kur përfitohet statusi “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar” apo “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”.



2. Komiteti i Investimeve Strategjike mund të vendosë, rast pas rasti, afate maksimale kohore për kohëzgjatjen e statusit “projekt me potencial strategjik” në favor të propozuesit, si mekanizëm nxitës për mbylljen në kohë të shkurtër të procedurave administrative dhe shmangien e vonesave nga investitori.

3. Projekti me statusin potencial strategjik propozohet nga ministrat e linjës, përgjegjës për projektin ose nga investitori propozues i projektit.

4. Ministrat e linjës, përgjegjës për një projekt me status potencial strategjik, propozojnë dhënien e statusit për ato projekte të konsideruara me interes publik, të propozuara e të organizuara nga organet shtetërore të qeverisjes qendrore apo vendore, për të cilat legjislacioni në fuqi parashikon kryerjen e procedurave konkurruese, koncesionare, të partneritetit publik, të prokurimeve publike, nëpërmjet garave, konkurseve apo tenderave publikë.

5. Në rastet e parashikuara në pikën 4, të këtij kreu, statusi “projekt me potencial strategjik” dhe asistenca përkatëse u ofrohet në mënyrë transparente dhe pa asnjë diskriminim të gjithë personave juridikë privatë, vendas dhe të huaj, të cilët, në cilësinë e subjekteve investuese të interesuara, marrin pjesë në garën, konkursin apo tenderin e shpallur nga organet shtetërore, paraqesin kërkesën për përfitimin e statusit “projekt me potencial strategjik” dhe plotësojnë kushtet ligjore, të përcaktuara në këtë vendim.

6. Subjekti investues i interesuar, i cili rezulton fitues në përfundim të procedurave konkurruese, në përputhje me pikën 4, të këtij kreu, mund të aplikojë më tej për përfitimin e statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar” apo “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”.

7. Në rastet kur propozimi për përfitimin e statusit “projekt me potencial strategjik” paraqitet nga ministrat e linjës, përgjegjës për projektin, atëherë kërkesa i përcillet Agjencisë, e cila duhet të shoqërohet me një relacion shpjegues për rëndësinë strategjike të projektit dhe duhet të përmbajë përshkrimin e detajuar të elementeve të mëposhtme:

a) Vlerës së përgjithshme të parashikuar të investimit;

b) Kohës së nevojshme për realizimin e investimit;

c) Produktivitetit dhe vlerës së shtuar që do të sjellë investimi;

ç) Mundësive të punësimit dhe të hapjes së vendeve të reja të punës që parashikohen si pasojë e investimit;

d) Përputhshmërisë së projektit me politikat dhe prioritetet ekonomike sektoriale;

dh) Mundësive të zhvillimit ekonomik rajonal dhe lokal që paraqet investimi;

e) Mundësive të zhvillimit e të përmirësimit të kushteve e standardeve për prodhimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve që paraqet investimi;

ë) Teknologjive të reja që sjell investimi, të cilat rritin konkurrencën dhe efektivitetin;

f) Rritjes së nivelit të përgjithshëm të sigurisë e të cilësisë së jetës së qytetarëve, si rezultat i realizimit të investimit;

g) Mbrojtjes së mjedisit dhe të konsumatorit, që garanton projektin.

8. Në rastet kur propozimi për përfitimin e statusit “projekt me potencial strategjik” paraqitet nga investitori propozues i projektit, kërkesa duhet të shoqërohet me planin e biznesit të investimit, në të cilin duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm:

a) Identiteti i investitorit dhe i partnerëve të tij;

b) Përshkrimi i detajuar i projektit të investimit;

c) Përshkrimi i detajuar i punëve që do të realizohen dhe i shërbimeve që do të ofrohen sipas projektit investues;

ç) Analiza e detajuar e afateve kohore që do të duhen për të realizuar projektin investues, si dhe fazat e realizimit të tij;

d) Përshkrimi i karakteristikave të investimit që i referohen specifikisht zhvillimit të teknologjive të reja dhe mbrojtjes së mjedisit;

dh) Analiza financiare e të gjithë projektit investues, si dhe analiza e shpenzimeve financiare që do të nevojiten për realizimin e çdo faze të projektit;

e) Analiza e detajuar për ndikimin që mund të kenë mbi mjedisin dhe në planet urbanistike punët dhe shërbimet e projektit;

ë) Analiza e detajuar e ndikimit ekonomik dhe social, të pritshëm nga realizimi i projektit investues;

f) Analiza e përfitimeve me interes publik që parashikohet të ketë shteti shqiptar nga realizimi i projektit.



9. Agjencia regjistron çdo kërkesë për marrjen e statusit “projekt me potencial strategjik”, në bazën e të dhënave të Regjistrit të Investimeve Strategjike, si dhe regjistron çdo ndryshim apo hap procedural të mëtejshëm.

10. Agjencia është struktura administrative kompetente për dhënien e shërbimeve në një “dritare unike” për investitorët dhe projektet me potencial strategjik. Për këtë qëllim, Agjencia organizon grupe operacionale specifike, të cilat kanë në përbërje ekspertë të ministrive të linjës, të fushave në të cilat kërkohet të realizohet investimi strategjik, për të asistuar dhe mbështetur profesionalisht në ndjekjen e të gjitha procedurave dhe përgatitjen e të gjitha akteve e dokumenteve ligjore, me qëllim përgatitjen, zbatimin, zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik të veçantë.

11. Grupi operacional i krijuar pranë Agjencisë, në ushtrimin e detyrave të përcaktuara sipas këtij vendimi:

a) përcakton procedurat për përgatitjen dhe zbatimin e çdo projekti potencial strategjik;

b) kryen të gjitha veprimet e nevojshme për të ndihmuar dhe mbështetur realizimin e projekteve;

c) harton listën përkatëse të dokumenteve të projektit;

ç) përgatit masat dhe planin e veprimit për realizimin e projektit;

d) kryen vlerësimin teknik, financiar e strategjik të projektit, të potencialit strategjik dhe të riskut operacional, si dhe të planit të veprimit për realizimin e projektit.

12. Nëse Agjencia, në bashkëpunim me institucionet/entet përgjegjëse për investimin strategjik, sipas fushave të përgjegjësisë, konstaton se dokumentacioni është i paplotë, i kërkon me shkrim propozuesit të projektit plotësimin e të gjitha dokumenteve dhe të dhënave të kërkuara. Agjencia ka të drejtë t’i kërkojë propozuesit të projektit informacione shtesë në lidhje me detajet e projektit, si dhe me aftësinë e tij për realizimin e suksesshëm të tij. Propozuesi i projektit duhet të plotësojë dokumentacionin brenda një afati prej 10 ditësh pune nga dita e marrjes së njoftimit.

13. Agjencia kryen të gjitha veprimet përgatitore, si dhe ofron shërbimet e nevojshme ndaj projektit potencial strategjik, përfshirë shërbime analize, vlerësimi, koordinimi informacioni, të konsolidimit të tokës, si dhe

shërbime përfaqësimi të investitorit tek institucionet/entet/autoritetet publike në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

14. Për kryerjen e vlerësimit të projekteve dhe të investitorëve strategjikë Agjencia ka të drejtë të kërkojë mendime dhe opinione nga Autoriteti i Konkurrencës, njësitë përkatëse të qeverisjes vendore apo agjenci ose institucione të tjera.

15. Agjencia kryen verifikimin e dokumentacionit të projektit, brenda një afati prej 30 ditësh pune nga data e paraqitjes së dosjes së plotë të informacionit nga investitori.

16. Agjencia informon Komitetin e Investimeve Strategjike për të gjitha projektet e paraqitura, procedurat e kryera, analizën e kryer dhe rekomandimet e hartuara prej saj. Pavarësisht nga vlerësimi pozitiv apo negativ i Agjencisë, çdo aplikim i paraqitet për shqyrtim Komitetit të Investimeve Strategjike, i shoqëruar me propozimin pozitiv apo negativ të Agjencisë, si dhe miratimin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë për përfitimin e statusit “projekt me potencial strategjik”.

17. Komiteti i Investimeve Strategjike, pas shqyrtimit të projektit dhe të analizës përfundimtare të paraqitur nga Agjencia, merr një vendim për pranimin apo refuzimin e kërkesës brenda një afati prej 30 ditësh pune nga data e dorëzimit të propozimit nga Agjencia.

18. Nëse Komiteti i Investimeve Strategjike konstaton se dokumentacioni është i paplotë apo ka nevojë për informacione shtesë, nëpërmjet Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, i kërkon propozuesit të projektit, vetëm një herë, me shkrim, brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së dosjes, plotësimin e të gjithë dokumentacionit dhe të dhënave të kërkuara, duke listuar kërkesat në mënyrë specifike. Propozuesi i projektit duhet të plotësojë dokumentacionin brenda 10 ditësh pune nga data e marrjes së njoftimit. Në këto raste, afati 30-ditor i vendimmarrjes zgjatet deri në plotësimin e dokumentacionit dhe shqyrtimin përfundimtar nga ana e Komitetit të Investimeve Strategjike.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Me marrjen e statusit “projekt me potencial strategjik” investitori ka të drejtë të përfitojë asistencën e mëtejshme të Agjencisë për përfitimin e statusit përfundimtar “Investim /investitor strategjik, procedurë e asistuar” apo



“Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”.

2. Investitori dhe organet kompetente mund të nënshkruajnë që në fazën e shprehjes së interesit paraprak dhe të veprimeve përgatitore, që zhvillojnë projektin potencial strategjik, një marrëveshje mirëkuptimi, në përputhje me përcaktimet e nenit 15, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”. Marrëveshja e mirëkuptimit përmban angazhimet e palëve për realizimin e projektit, duke përfshirë nga njëra anë shërbimet që organet kompetente do të ofrojnë në favor të projektit strategjik, si dhe angazhimet që do të ndërmerren investitori potencial për përgatitjen dhe zbatimin e projektit investues strategjik.

3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe ministritë përgjegjëse për projektet e investimeve strategjike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1025, datë 16.12.2015

**PËR SHËRBIMET E PROMOVIMIT DHE
PËRFAQËSIMIT TË INVESTIMEVE
STRATEGJIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**I. SHËRBIMET E PROMOVIMIT TË
INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

1. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve zhvillon dhe blen shërbime të promovimit, nxitjes dhe tërheqjes së investimeve strategjike, duke promovuar klimën e biznesit, procedurat lehtësuese, masat mbështetëse dhe kuadrin ligjor favorizues për investimet

strategjike, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Në shërbimet e promovimit përfshihen, por pa u kufizuar, kryerja e veprimtarive të tilla, si marketing, reklama, publicitete, veprimtari dhe materiale informuese, përfshirë publikime në media të shkruara, audio/televizive, si dhe shërbime promovimi në takime, seminare, konferenca, panaire, evente dhe veprimtari kombëtare e ndërkombëtare, ku mund të realizohen më së miri qëllimet e promovimit.

3. Shërbimet e promovimit mund të kryhen nga vetë Agjencia, nëpërmjet stafit të saj, duke përdorur burimet, fondet dhe kapacitetet e saj.

4. Agjencia ka të drejtë të kontrakttojë subjekte të specializuara, vendase ose të huaja, për kryerjen e veprimtarive të promovimit të kuadrin ligjor favorizues për investimet strategjike në tregjet ndërkombëtare.

5. Agjencia kontraktton shërbimet e promovimit me palët e treta, sipas kontratave të lidhura në përputhje me parimet dhe rregullat e legjislacionit për prokurimet publike.

**II. SHËRBIMET E PËRFAQËSIMIT TË
INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

1. Agjencia, në emër dhe për llogari të shtetit, mund të kontrakttojë në tregjet ndërkombëtare shërbime të përfaqësimit për investimet strategjike, nëpërmjet agjentëve ndërkombëtarë të investimeve.

2. Agjentët ndërkombëtarë mund të kontaktohen nga vetë Agjencia ose mund të dorëzojnë aplikimet e tyre pranë Agjencisë, me qëllim njohjen e statusit të agjentit ndërkombëtar që gëzon të drejtën e ofrimit të shërbimeve të përfaqësimit.

3. Agjentët ndërkombëtarë, për kryerjen e shërbimeve të përfaqësimit, identifikohen, vlerësohen dhe përzgjidhen nga Agjencia duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

- a) Të provojnë eksperiencën e tyre për kryerjen e shërbimeve të përfaqësimit;
- b) Të gëzojnë një reputacion të mirë në tregjet ku operojnë;
- c) Të dëshmojnë mungesën e dënimeve penale;
- ç) Të kenë një nivel të lartë morali, etike dhe profesionaliteti.

4. Me qëllim verifikimin e plotësisht të këtyre kriterëve, Agjencia u kërkon agjentëve



ndërkombëtarë paraqitjen e dokumentacionit, i cili, sipas vlerësimit të Agjencisë, dëshmon përmbushjen e kriterëve të sipërpërmendura.

5. Në rast se Agjencia merr dijeni për mospërmbushjen apo shkeljen e këtyre kriterëve nga agjentët ndërkombëtarë, ajo i revokon menjëherë tagrat dhe titullin e përfaqësimit të dhënë në emër të shtetit shqiptar dhe publikon këtë fakt në mënyrë të përshtatshme duke njoftuar, sipas rastit, edhe investitorët potencialë strategjikë të prekur. Agjentët mbajnë përgjegjësi penale për deklarimet e rreme, fshehjen e të dhënave ose prodhimin e dokumenteve provuese të parregullta.

6. Për përcaktimin e rregullave dhe të mënyrës së kryerjes së shërbimeve të përfaqësimit, Agjencia nënshkruan marrëveshje të posaçme me agjentët ndërkombëtarë të investimeve, në të cilat përcaktohen të drejtat, detyrimet dhe angazhimet e palëve, si dhe afati kohor i mandatit të përfaqësimit.

7. Në marrëveshjet e lidhura për shërbimet e përfaqësimit përcaktohen, midis të tjerash, rregullat e përdorimit të titullit të përfaqësimit, shërbimet e veprimtaritë që do të ndërmerren, si dhe rregullat e etikës e të standardeve profesionale që duhet të zbatojnë agjentët ndërkombëtarë gjatë kryerjes së shërbimeve të përfaqësimit të shtetit.

8. Shërbimet e përfaqësimit të kryera nga agjentë ndërkombëtarë nuk do të kenë kosto në ngarkim të shtetit shqiptar, por mund të përballohen nga vetë investitorët strategjikë, sipas marrëveshjeve të lidhura nga vetë agjentët ndërkombëtarë me investitorët strategjikë. Në asnjë rast, Agjencia nuk merr pjesë si palë dhe nuk merr përsipër detyrime kontraktore në marrëveshjet e lidhura midis agjentëve ndërkombëtarë dhe investitorëve strategjikë.

9. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1026, datë 16.12.2015

PËR VLERËSIMIN E DOKUMENTACIONIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR PËRFSHIRJEN NË PROCEDURAT ADMINISTRATIVE TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

1. Çdo subjekt investues i interesuar, person juridik privat, vendas ose i huaj, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, ka të drejtën për të kërkuar përfshirjen e një projekti investues në procedurat administrative të investimeve strategjike, me qëllim marrjen e statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar” apo “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”.

2. Subjektet e interesuara, të cilat kërkojnë përfshirjen e projekteve të tyre investuese në procedurat administrative të investimeve strategjike, paraqesin, për këtë qëllim, një kërkesë me shkrim pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, së bashku me dokumentacionin përkatës.

3. Agjencia vlerëson, fillimisht, nëse projekti i paraqitur u përket sektorëve e nënsektorëve strategjikë, si dhe vlerat minimale të investimit, të parashikuara nga ligji nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, agjencia verifikon nëse projekti mbivendoset me projekte apo aktivitete të tjera, të miratuara më parë.

4. Dokumentacioni që paraqitet nga subjektet investuese, për realizimin e projektit/investimit strategjik, duhet të përfshijë, detyrimisht:

- a) planin e biznesit;
- b) planin dhe burimet e financimit;



c) programin e punës dhe afatet e parashikuara, të detajuara me fazat dhe veprimet përkatëse;

ç) vlerësimin e ndikimit social, ekonomik dhe strategjik të projektit;

d) studimin e fizibilitetit;

dh) përfitimet ekonomike, sociale dhe operacionale, si dhe nivelin e punësimit, që parashikohen të realizohen;

e) listën me të gjitha masat, incentivat dhe shërbimet mbështetëse që subjekti investues kërkon nga shteti shqiptar, për realizimin e projektit investues;

ë) dokumentacionin që provon kapacitetet financiare për realizimin e projektit investues, si mënyrë garancie për zbatimin dhe zhvillimin e tij, sipas kërkesave të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore përkatëse;

f) deklaratën e subjektit investues të interesuar, me anë të së cilës subjekti merr përsipër dhe garanton vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura në dosje;

g) autorizimin me shkrim, nga ana e investitorit, me të cilin autorizohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për të kryer të gjitha verifikimet e nevojshme të të dhënave të paraqitura në dosje;

gj) pranimin e shprehur të investitorit për publikimin e detajeve të përgjithshme të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t’u shfaqen personave të tretë, të përcaktuara, shprehimisht, nga subjekti i interesuar;

h) mandatpagesën për tarifat e aplikueshme.

5. Subjektet e interesuara paraqesin dokumentacionin përkatës, i cili vërteton se subjekti:

a) nuk është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;

b) nuk është dënuar, me vendim gjykatë të formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

c) kapitalet dhe asetet nuk janë objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm, nga ana e shërbimit përmbartimor;

ç) i ka përmbushur, rregullisht, detyrimet në lidhje me pagesat e taksave dhe tatimeve;

d) i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore.

6. Dokumentacioni i kërkuar paraqitet në format dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.

7. Në çdo rast, agjencia ka detyrimin që të këshillojë, informojë dhe të komunikojë, në mënyrë të vazhdueshme, me subjektet investuese të interesuara, në lidhje me formën, modalitetet dhe procedurat specifike të dokumentacionit që duhet të paraqitet për një projekt specifik. Për këtë qëllim, agjencia duhet t’u japë subjekteve të interesuara, në mënyrë të qartë, transparente dhe brenda afateve të arsyeshme, listën e dokumentacionit të kërkuar për projektin përkatës, së bashku me udhëzimet dhe shpjegimet përkatëse, dhe duhet t’u përgjigjet kërkesave të tyre për informacion brenda 5 ditëve pune, nga data e paraqitjes së kërkesës.

II. VLERËSIMI I DOKUMENTACIONIT

1. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, pas marrjes së kërkesës dhe të dokumentacionit përkatës, kryen një vlerësim paraprak teknik, financiar e strategjik të potencialit strategjik të projektit, duke u bazuar në interesin publik të projektit.

2. Vlerësimi paraprak i projektit, nga ana e agjencisë, bazohet në:

a) vlerën totale të parashikuar të investimit;

b) kohën e nevojshme të realizimit të investimit të propozuar;

c) produktivitetin dhe vlerën e shtuar, që vlerësohet se do të sjellë investimi;

ç) mundësitë e punësimit dhe hapjen e vendeve të reja të punës, që parashikohen si pasojë e investimit;

d) përputhshmërinë e projektit me politikat dhe prioritetet ekonomike sektoriale;

dh) mundësitë e zhvillimit ekonomik, rajonal dhe lokal, që paraqet investimi;

e) mundësitë e zhvillimit apo përmirësimit të kushteve dhe standardeve për prodhimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve, që paraqet investimi;

ë) ofrimin e teknologjive të reja që sjell investimi dhe mundësitë për të rritur konkurrencën dhe efektivitetin e tregut;

f) ndikimin që ka projekti për rritjen e nivelit të përgjithshëm të sigurisë dhe cilësisë së jetës së qytetarëve;

g) nivelin e mbrojtjes së mjedisit dhe të konsumatorit, që garanton investimi.



3. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve verifikon dokumentacionin e depozituar nga subjekti i interesuar dhe kryen vlerësimin e projektit me potencial strategjik, brenda 30 ditëve pune nga data e paraqitjes së dosjes së plotë të projektit.

4. Vlerësimi i potencialit të projektit, nga agjencia, kryhet nëpërmjet grupeve operacionale, të posaçme për çdo projekt, të përbërë nga ekspertë të ministrive të linjës, të fushave në të cilat kërkohet të realizohet investimi strategjik.

5. Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur rezulton të jetë i paplotë ose i paqartë, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe/ose organet e tjera shtetërore, të përfshira në procedurat administrative të investimeve strategjike, nëpërmjet agjencisë, i kërkojnë subjektit investues, vetëm një herë, me shkrim, brenda 10 ditëve pune, nga data e marrjes së dosjes, plotësimin e të gjithë dokumentacionit dhe të dhënat e kërkuara, duke listuar kërkesat në mënyrë specifike. Subjekti investues duhet të plotësojë dokumentacionin brenda 10 ditëve pune, nga data e marrjes së njoftimit.

6. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, kur arrin në përfundimin se projekti paraqet potencial strategjik dhe, si i tillë, duhet mbështetur, si në fazën e shprehjes së interesit paraprak, ashtu edhe gjatë fazës së vlerësimit paraprak apo të kryerjes së veprimeve përgatitore, dhe pas miratimit nga ministri përgjegjës për ekonominë, mund t'i propozojë Komitetit të Investimeve Strategjike që të autorizojë agjencinë apo ministrin përgjegjës të linjës, sipas projektit specifik, për negocimin, lidhjen dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje mirëkuptimi, në të cilën parashikohen shërbimet, zotimet dhe premtimet e ndërsjella të qeverisë dhe të investitorit për hartimin, përgatitjen dhe zbatimin e projektit investues strategjik. Kjo marrëveshje do të kushtëzohet nga vendimi përfundimtar i Komitetit të Investimeve Strategjike, në lidhje me miratimin apo refuzimin e projektit.

7. Agjencia informon Komitetin e Investimeve Strategjike për të gjitha projektet e paraqitura, procedurat e kryera, analizën dhe rekomandimet e hartuara prej saj. Pavarësisht vlerësimit pozitiv apo negativ të agjencisë, çdo aplikim i paraqitet për shqyrtim Komitetit të

Investimeve Strategjike, i shoqëruar me propozimin, pozitiv apo negativ, të agjencisë, për përfitimin e statusit “projekt me potencial strategjik”, brenda 10 ditëve nga plotësimi i afatit të përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi.

8. Komiteti i Investimeve Strategjike, pas shqyrtimit të projektit dhe të analizës përfundimtare të paraqitur nga agjencia, merr një vendim, në lidhje me pranimin apo refuzimin e kërkesës, brenda një afati 30-ditor, nga data e dorëzimit të propozimit prej agjencisë.

9. Komiteti i Investimeve Strategjike, nëse konstaton se dokumentacioni është i paplotë apo ka nevojë për informacione shtesë, nëpërmjet Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, i kërkon propozuesit të projektit, vetëm një herë, me shkrim, brenda 10 ditëve pune, nga data e marrjes së dosjes, plotësimin e të gjithë dokumentacionit dhe të dhënat e kërkuara, duke listuar kërkesat në mënyrë specifike. Propozuesi i projektit duhet të plotësojë dokumentacionin brenda 10 ditëve pune, nga data e marrjes së njoftimit. Në këto raste, afati 30-ditor i vendimarrjes zgjatet deri në plotësimin e dokumentacionit dhe shqyrtimin përfundimtar nga ana e Komitetit të Investimeve Strategjike.

10. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike, në lidhje me miratimin, refuzimin apo revokimin e statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”, i njoftohet, me shkrim, kërkuarit, nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 1027, datë 16.12.2015

PËR TARIKAT E SHËRBIMEVE PËR INVESTIMET STRATEGJIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 16, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e



Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimet në favor të projekteve dhe investitorëve strategjikë ofrohen nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila kryen rolin e “dritares unike” dhe është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve me një ndalesë për projektet dhe investimet strategjike, kundrejt aplikimit të tarifave përkatëse.

2. Tarifat që aplikohen për shërbimet ndaj investitorëve dhe investimeve strategjike janë:

a) tarifa e kostove dhe e shërbimeve administrative;

b) tarifa e menaxhimit të procedurave të investimeve strategjike.

3. Tarifa e kostove dhe e shërbimeve administrative mbulon kostot e shpenzimet për të gjitha shërbimet e kryera nga agjencia, që nga momenti i paraqitjes së aplikimit deri në momentin e marrjes së vendimit, në lidhje me miratimin ose jo të statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar”, apo “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”, nga Komiteti i Investimeve Strategjike.

Këto shërbime përfshijnë, por pa u kufizuar:

a) shkëmbimet e informacionit;

b) komunikimet postare;

c) kopjet e akteve shkresore dhe/ose elektronike, të cilat agjencia ua merr ose transmeton investitorit dhe organeve shtetërore të përfshira në procedurat e investimeve strategjike;

ç) shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti investues i interesuar;

d) analizën paraprake të profilit të investitorit, përfshirë studimin e deklaratave financiare, të strukturës menaxheriale, pronësisë, pozicionimit në treg, eksperiencave të mëparshme;

dh) vlerësimin teknik, financiar dhe strategjik të projektit të investimit strategjik, të potencialit të tij strategjik, të riskut operacional dhe të planit të veprimit për realizimin e tij;

e) shërbime analize, vlerësimi, koordinimi informacioni, të konsolidimit të tokës dhe shërbime përfaqësimi të investitorit tek organet shtetërore;

ë) mbështetjen paraprake të një projekti me potencial strategjik, përfshirë asistencën ndaj

subjektit investues për mbledhjen e informacionit me të dhënat e karakterit teknik, ligjor, administrativ etj., të nevojshme për hartimin, përgatitjen dhe zbatimin e investimit;

f) shërbimet në lidhje me negocimin, lidhjen dhe nënshkrimin e marrëveshjeve me investitorin.

4. Tarifa e kostove dhe e shërbimeve administrative ka një vlerë fikse prej 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekësh. Pagesa e kësaj tarife kryhet nga subjektet e interesuar, në momentin e aplikimit për kryerjen e veprimeve dhe procedurave të investimeve strategjike, pranë Agjencisë.

5. Tarifa e menaxhimit të procedurave të investimeve strategjike përfshin të gjitha shërbimet mbështetëse që kryen agjencia pas përfitimit të statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar”, apo “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”.

Këto shërbime përfshijnë, por pa u kufizuar:

a) kryerjen e veprimeve përgatitore, përgatitjen e dokumenteve dhe aplikimin administrativ me procedurë të përshpejtuar, përfshirë dokumentet e nevojshme që shoqërojnë aplikimin;

b) trajtimin me prioritet të përgatitjes së dokumentacionit, dhënien e mendimeve dhe ndjekjen e procedurave;

c) veprimet për konsolidimin e tokës, të cilat kanë si qëllim ripërshtatjen dhe ristrukturimin e planifikuar të parcelave të tokës dhe të pronësisë së tyre. Këto veprime mund të përfshijnë ndryshimin e formës, pronësisë, të regjimit juridik dhe shfrytëzimit të tokës, ose kombinime të tyre;

ç) përgatitjen dhe ofrimin e programeve mbështetëse;

d) veprimet në lidhje me realizimin e procedurave për mbështetjen me infrastrukturë ndihmëse;

dh) vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore, për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike;

e) dërgimin e dosjes së subjektit investues për marrjen e licencave/lejeve/autorizimeve, pranë organeve publike kompetente;

ë) veprimet mbështetëse në lidhje me shpronësimin e pasurive të paluajtshme, pronë private, për të mundësuar zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike;

f) veprimet për përgatitjen dhe përcjelljen për miratim, nga ana e Kuvendit, të kontratave përkatëse të investimit strategjik, në përputhje me



rastet dhe procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

6. Tarifa e menaxhimit të procedurave të investimeve strategjike ka një kosto fikse prej 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekësh. Paguesa e kësaj tarife kryhet nga subjektet e interesuara dhe dorëzohet së bashku me dokumentacionin e kërkuar për miratimin e statusit “Investim /investitor strategjik, procedurë e asistuar”, apo “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”.

7. Tarifat e përcaktuara në këtë vendim nuk përfshijnë tarifën dhe shpenzimet e tjera, të cilat aplikohen nga legjislacioni në fuqi për marrjen e lejeve, licencave apo autorizimeve, ose për veprime të tjera, në lidhje me projektin apo investimin strategjik. Kostot përkatëse për përbalimin e tyre përballohen nga investitori dhe paguhen së bashku me tarifën e përcaktuara nga ky vendim.

8. Tarifat e përcaktuara në këtë vendim nuk aplikohen për shërbimet e kryera nga agjencia për mbështetjen paraprake të një projekti strategjik, në rastet kur propozuesi është një organ shtetëror.

9. Të ardhurat që realizohen nga arkëtimi i pagesës së këtyre tarifave derdhen, tërësisht, në buxhetin e shtetit.

10. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1028, datë 16.12.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E MARZHEVE,
RREGULLAVE DHE
DOKUMENTACIONIT TË GARANCIVE
FINANCIARE TË INVESTIMEVE
STRATEGJIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 8, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personat juridikë privatë, vendas e të huaj, të cilët, në cilësinë e subjekteve investuese të interesuara për zhvillimin dhe realizimin e një investimi strategjik, kërkojnë përfshirjen e projektit investues në procedurat administrative të investimeve strategjike, me qëllim marrjen e statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar”, apo “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”, përveç dokumentacionit të kërkuar, në lidhje me projektin, duhet të paraqesin, pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, dokumentacionin që provon kapacitetet financiare për realizimin e projektit investues, si mënyrë garancie për zbatimin dhe zhvillimin e projektit.

2. Dokumentacioni që provon kapacitetet financiare për realizimin e projektit investues duhet të përmbajë të dhëna financiare që dëshmojnë aftësinë e investitorit për realizimin e investimit, në masën jo më pak se 10 % të vlerës totale të tij.

3. Garancitë financiare për marrjen e statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar” apo “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë” paraqiten në momentin e aplikimit dhe/ose të nënshkrimit të kontratës, në rastet kur, sipas ligjit të aplikueshëm, nënshkruhet një kontratë e tillë me shtetin.

4. Kufiri minimal i garancive financiare të jetë në masën, jo më pak se, 10 % të vlerës totale të investimit. Komiteti i Investimeve Strategjike, në varësi të karakteristikave, përmasave dhe kompleksitetit të projektit, eksperiencës e kapaciteteve të investitorit, si dhe në varësi të interesit publik, mund të kërkojë nivele më të larta të përqindjes së kapaciteteve financiare të kërkuara, por jo më tepër se 20 % të vlerës totale të investimit.

5. Vlera e kapaciteteve financiare të kërkuara për realizimin e investimit mund të dëshmohet nëpërmjet:

a) kapaciteteve financiare të vetë investitorit, të provuara dhe siç rezultojnë nga pasqyrat financiare të audituara e të depozituara pranë administratës tatimore, të 3 viteve të fundit, kur kjo është e mundur, ose, nëse është themeluar pas këtij afati, të viteve/it të fundit;

b) financimit dhe kreditimit të përshtatshëm, nga ana e instituteve bankare ose financiare,



vendase ose të huaja, me reputacion të mirënjohur dhe besueshmëri të lartë;

c) ofrimit të garancive financiare nga ana e instituteve bankare ose financiare, vendase apo të huaja, me reputacion të mirënjohur dhe besueshmëri të lartë.

6. Në rastet kur realizimi i investimit do të kryhet nëpërmjet një shoqërie të krijuar posaçërisht, të themeluar nga investitori, dokumentacioni, në lidhje me kapacitetet financiare, do të paraqitet nga investitori /shoqëria/shoqëritë zotëruese të Subjektit për Qëllime të Veçanta (SPV).

7. Në rastet kur investitori dëshmon aftësinë për realizimin e investimit me anë të kapaciteteve të tij, Komiteti i Investimeve Strategjike mund t'i kërkojë investitorit marrjen përsipër të detyrimit për ruajtjen dhe moszvogëlimin e kapitalit e të kapaciteteve financiare të tij përtej një niveli minimal garancie, përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të investimit strategjik, si dhe detyrimin për të kërkuar miratimin paraprak, për çdo rast të transferimit të kuotave/aksioneve të shoqërisë. Gjithashtu, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë t'i kërkojë investitorit dokumente për garanci apo mbështetje të mëtejshme financiare nga partnerë apo institucione të besueshme financiare, të cilat mbështetin projektin, nëse nga informacioni dhe dokumentet e paraqitura nuk provohet, në mënyrë bindëse dhe të qartë, kapaciteti financiar për të mbuluar me aktivet e tij pjesën e kërkuar prej 10 % të vlerës së investimit.

8. Në rastet kur investitori dëshmon aftësinë për realizimin e investimit, nëpërmjet financimit, kreditimit apo ofrimit të garancive nga ana e instituteve bankare ose financiare, Komiteti i Investimeve Strategjike autorizon Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve për vlerësimin e formës së përshtatshme të dokumenteve dhe verifikimin periodik të vlefshmërisë së instrumenteve të financimit dhe garancisë. Komiteti i Investimeve Strategjike duhet të informohet nga investitori për çdo ndryshim të këtyre dokumenteve, i cili duhet të miratohet nga Komiteti i Investimeve Strategjike, me qëllim ruajtjen e statusit të "Investim /investitor strategjik, procedurë e asistuar", apo "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë".

9. Në të gjitha rastet, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë t'i kërkojë investitorit informacion në lidhje me kapacitetin financiar dhe aftësinë e tij për të gjeneruar fonde të mjaftueshme për financimin e gjithë investimit. Këto informacione përfshijnë, por pa u kufizuar, dokumente mbi situatën financiare, strukturën e administrimit, pronësinë e pasurive dhe asetëve, pozicionimin në treg, eksperiencat e mëparshme, mbështetjen financiare të partnerëve apo investitorëve të jashtëm, si dhe informacion tjetër të nevojshëm, për të provuar aftësitë e tij investuese dhe potencialin për të qenë investitor strategjik për projektet e investimeve strategjike.

10. Forma e dokumentacionit, vlera dhe kushtet thelbësore të garancive financiare të çdo projekti vendosen, rast pas rasti, nga Komiteti i Investimeve Strategjike, në përputhje me nivelet e marzheve dhe me përcaktimet e këtij vendimi. Për vlerësimin e elementeve të garancive financiare të kërkuara, Komiteti i Investimeve Strategjike merr në konsideratë balancimin e interesave publike me ato të investitorëve dhe vlerëson karakteristikat specifike të çdo projekti.

11. Të drejtat dhe detyrimet e palëve përcaktohen nëpërmjet nënshkrimit të një marrëveshjeje të posaçme për kushtet, mënyrën e realizimit të investimit dhe ofrimit të garancive financiare. Në veçanti, marrëveshjet e posaçme duhet të përmbajnë detyrimet financiare për ruajtjen e gjendjes financiare të investitorit, në përputhje me pikat 6 e 7, të këtij vendimi, si dhe duhet të parashikojnë sanksione të përshtatshme ndaj atij që kryen deklaratime të rreme për gjendjen financiare, që ndryshon dokumentet e financimit, kreditimit apo garancive, pa miratimin e Komitetit të Investimeve Strategjike, nuk realizon investimin në vlerat e përcaktuara dhe nuk respekton kushtet e projektit të investimit apo kryen veprime në shkelje të lejeve, licencave apo autorizimeve të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi. Marrëveshjet e posaçme mund të nënshkruhen nga Komiteti i Investimeve Strategjike, nga një organ tjetër i autorizuar prej tij ose nga organi përgjegjës, i përcaktuar sipas legjislacionit specifik të veprimtarisë përkatëse.

12. Në rastin e investimeve që kërkojnë të përfitojnë statusin e investimeve strategjike, për të cilat është nënshkruar një kontratë para hyrjes



në fuqi të këtij ligji, dhe për të cilin investitori ka realizuar mbi 10 % të vlerës së investimit, Komiteti i Investimeve Strategjike mund të konsiderojë të arsyeshme mosparaqitjen e garancisë financiare, me kusht që të paraqitet një certifikim i investimit të kryer, i hartuar nga vlerësues të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi, dhe konfirmimit nga autoriteti kontraktues.

13. Garancitë dhe informacionet financiare, për qëllimet e investimeve strategjike, nuk kërkohen në rastet e projekteve publike, të konsideruara si investime strategjike, të iniciuara dhe të financuara nga shteti, nëpërmjet fondeve buxhetore, granteve apo financimeve të ndryshme. Ky përcaktim nuk përjashton paraqitjen e garancive të tjera, të kërkuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

14. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1029, datë 16.12.2015

PËR BASHKËPUNIMIN NDËRINSTITUCIONAL NË PROCEDURAT E INVESTIMEVE STRATEGJIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PROCEDURAT DHE AFATET PËR SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT

1. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rastet kur, për qëllim të realizimit të funksioneve të saj në lidhje me investimet strategjike, i nevojiten të dhëna apo informacione që disponohen nga një institucion tjetër, ka të drejtë që, nëpërmjet procedurës së përshpejtuar, të

kërkojë nga organet e qeverisjes qendrore dhe vendore sigurimin e të dhënave, informacioneve apo çdo lloj ndihme tjetër të nevojshme për realizimin e detyrave funksionale.

2. Kërkesa për informacion ose të dhëna e agjencisë, drejtuar organeve të tjera, duhet të përmbajë:

a) llojin e të dhënave apo informacionit që kërkohet për një investim strategjik;

b) argumentimin e trajtimit të procedurës me prioritet, si rrjedhojë e parashikimeve të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”;

afatin, brenda të cilit duhen dërguar të dhënat apo informacioni i kërkuar;

ç) nënshkrimin e titullarit të institucionit apo personit përgjegjës.

3. Organet publike shtetërore, të cilat marrin një kërkesë për informacion nga agjencia, duhet të kthejnë përgjigje për kërkesën për bashkëpunim, bashkë me informacionin dhe të dhënat e kërkuara, brenda një afati maksimal prej 7 ditësh pune.

4. Afati për kthimin e përgjigjeve fillon nga e nesërmbja e protokollimit të tyre në institucionin përkatës dhe mbaron në ditën e fundit të afatit të përcaktuar, brenda orarit zyrtar të asaj dite.

5. Institucioni pritës, për shkaqe me rëndësi dhe duke dhënë një përgjigje të arsyetuar, mund të shtyjë përgjigjen e tij, sipas rastit, deri në 3 ditë pune të tjera.

6. Në rastin kur kërkohen të dhëna apo informacione, për të cilat kërkohen njohuri dhe ekzaminime të posaçme, afati për kthimin e përgjigjes është jo më shumë se 20 ditë pune.

7. Në rast se përgjigja, informacioni apo të dhënat e kërkuara nuk janë të plota, agjencia ka të drejtë të kërkojë plotësimin e tyre, brenda 3 ditëve pune, nga marrja e kërkesës për plotësim informacioni.

II. PROCEDURA DHE AFATET PËR MIRATIMIN E LEJEVE, LICENCAVE DHE AUTORIZIMEVE

1. Me qëllim realizimin e projekteve të investimeve strategjike, të cilat kanë përfituar statusin “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/ e veçantë”, dhe kanë nevojë, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, për pajisjen me leje, licenca, autorizime apo miratime të ngjashme, agjencia asiston investitorët strategjike gjatë këtyre procedurave, duke ndërmjetësuar në marrëdhëniet



me organet shtetërore kompetente. Agjencia, brenda 5 ditëve pune, nga data e paraqitjes së dosjes së plotë, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet nga legjislacioni sektorial për miratimin e lejeve, licencave dhe autorizimeve, së bashku me mandatpagesat e tarifave përkatëse, ia përcjell dosjen e investitorit strategjik organit kompetent për lëshimin e tyre.

2. Organi kompetent për lëshimin e lejeve, licencave dhe autorizimeve, me marrjen e dokumentacionit nga agjencia, brenda 15 ditëve pune, lëshon këto dokumente, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Përjashtimisht dhe vetëm për shkaqe të arsyeshme, që lidhen me kompleksitetin e lejeve, licencave dhe autorizimeve, afati mund të shtyhet vetëm një herë, për një periudhë kohe prej 15 ditësh pune.

4. Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur rezulton të jetë i paplotë ose i paqartë, organet kompetente, nëpërmjet agjencisë, i kërkojnë investitorit strategjik, vetëm një herë, me shkrim, brenda 10 ditëve pune, nga data e marrjes së dosjes, plotësimin e të gjithë dokumentacionit dhe të dhënat e kërkuara, duke listuar kërkesat në mënyrë specifike.

III. GRUPE TË OPERACIONALE

1. Asistenca dhe mbështetja ndaj investimeve dhe projekteve strategjike kryhet nga agjencia, nëpërmjet grupeve operationale të krijuara pranë saj, të ngritura posaçërisht, për çdo projekt të investimeve strategjike. Grupet operationale përbëhen nga ekspertë, teknikë dhe profesionistë të ministrive të linjës, në fushat në të cilat kërkohet të realizohet investimi strategjik. Grupi operational ka si objekt të veprimtarisë së tij ndjekjen e të gjitha procedurave dhe përgatitjen e të gjitha akteve e dokumenteve ligjore, me qëllim përgatitjen, zbatimin, zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik të veçantë.

2. Grupet operationale ngrihen me propozimin e agjencisë dhe me nismën e ministrit përgjegjës për ekonominë, me anë të një urdhri të përbashkët të ministrave të përfshirë në projektin e investimeve strategjike. Me qëllim respektimin e afateve të përshpejtuara të procedurave administrative, për investimet strategjike, ministrat përgjegjës për projektin strategjik, brenda 10 ditëve, nga marrja e kërkesës së ministrit përgjegjës për ekonominë, përcaktojnë personat pjesëmarrës në

grupin operational, si dhe personat/strukturat e kontaktit, të cilët do të jenë përgjegjës për komunikimet me agjencinë, në lidhje me investimet strategjike.

3. Urdhri i përbashkët për ngritjen e grupit operational të punës, për realizimin e një projekti ose investimi strategjik, përcakton:

a) qëllimin e ngritjes së grupit;

b) objektin e tij;

c) funksionimin e grupit në strukturën e agjencisë;

ç) numrin e punonjësve që do të përfshihen dhe ndarjen e detyrave përkatëse;

d) rregullat për vendimmarrjen e grupit;

dh) përcaktimin e infrastrukturës, nëse është e nevojshme;

e) mjetet financiare, nëse është e nevojshme;

ë) afatet, brenda të cilit grupi i punës duhet të realizojë detyrat e tij, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.

4. Grupi operational i punës kryesohet nga drejtori ekzekutiv i agjencisë, i cili përfaqëson grupin në marrëdhëniet me organet shtetërore dhe investitorët strategjikë.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për sa nuk është parashikuar shprehimisht në këtë vendim dhe që nuk bie në kundërshtim me të, zbatohen rregullat e përcaktuara me vendimin nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore, të përfshira në procedurat për investimet strategjike, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 1030, datë 16.12.2015****PËR ORGANIZIMIN DHE FORMËN E
PJESËMARRJES SË SHTETIT NË
INVESTIMET STRATEGJIKE DHE
RREGULLAT PËR KRIJIMIN,
FUNKSIONIMIN E ADMINISTRIMIN E
FONDIT TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME PËR MBËSHJETJEN E
INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 30 e 31, pika 2, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. RREGULLAT DHE FORMAT E
PJESËMARRJES SË SHTETIT NË INVESTI-
MET STRATEGJIKE**

1. Në këto rregulla përcaktohen procedurat, dokumentet dhe hapat që duhet të ndiqen nga investitorët strategjikë dhe organet kompetente shtetërore, në lidhje me mundësinë e pjesëmarrjes së shtetit, si bashkëpjesëmarrës në investim, së bashku me subjektet private të cilat kanë përfituar statusin e investitorëve strategjikë, me qëllim realizimin e investimeve strategjike.

2. Pjesëmarrja e shtetit në investimet strategjike mund të realizohet në format e mëposhtme:

a) Shteti vepron si bashkëzhvillues i investimit strategjik;

b) Shteti vepron si bashkëzhvillues i një zone territoriale të caktuar, në të cilën realizohen investime strategjike;

c) Shteti vepron si bashkëpjesëmarrës në investim në forma të tjera, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

3. Shteti mund të veprojë si bashkëzhvillues i një investimi strategjik duke marrë pjesë si ortak/aksionar në shoqërinë tregtare që do të realizojë investimin strategjik, nëpërmjet kontributit në kapital, me para dhe/ose në natyrë. Pjesëmarrja e shtetit në shoqëri kryhet sipas mënyrave, formave dhe rregullave të përcaktuara nga legjislacioni tregtar shqiptar.

4. Shteti mund të jetë bashkëpjesëmarrës për realizimin e një investimi strategjik, duke vepruar në rolin e zhvilluesit të një zone territoriale të caktuar, në të cilën realizohen investime strategjike. Në këtë rast, shteti mund të mbështetë investimin strategjik, duke marrë masa për zhvillimin e zonës, të tilla si: përmirësimi dhe zhvillimi i objekteve dhe i infrastrukturave ekzistuese, ndërtimi i infrastrukturave të reja ose marrja e masave të tjera mbështetëse.

5. Përveç këtyre formave, shteti mund të veprojë si bashkëpjesëmarrës në investim në çdo formë tjetër të parashikuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi. Në këto forma bashkëpjesëmarrjeje mund të përfshihen, por pa u kufizuar, vënia në dispozicion e pasurive të paluajtshme apo të luajtshme, e aseteve, makinerive, të drejtave apo lehtësive të ndryshme, dhënia e së drejtës për përdorimin e brigjeve, si dhe kombinime të tyre apo forma të tjera mbështetjeje.

Bashkëpjesëmarrja e shtetit në një investim strategjik shpërblehet nëpërmjet pagesës së tarifave, produkteve apo fitimeve të realizuara nga investimi strategjik apo nëpërmjet formave të tjera të përcaktuara në kontratën me investitorin strategjik.

Pjesëmarrja e shtetit në investimet strategjike dhe përfitimet përkatëse në favor të shtetit përcaktohen në kontratat përkatëse që nënshkruhen nga shteti me investitorin strategjik, sipas mënyrave, formave dhe rregullave të përcaktuara nga legjislacioni sektorial.

6. Pjesëmarrja e shtetit në investimet strategjike realizohet në përputhje me interesin publik, duke respektuar parimet e transparencës, të paanshmërisë, të barazisë e të mbrojtjes së konkurrencës dhe tregut të lirë.

Pjesëmarrja, mbështetja dhe nxitja shtetërore për një investim strategjik nuk duhet të sjellin, si pasojë, pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg.

Pjesëmarrja shtetërore duhet të jetë në nivele të tilla, të cilat nuk shuajnë ose e reduktojnë ndjeshëm riskun operacional në ngarkim të investitorit strategjik, si dhe në nivel të drejtë proporcionaliteti me vlerën dhe rëndësinë e investimit.

Për këtë qëllim, përpara se të propozohet pjesëmarrja e shtetit në një investim strategjik, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve u kërkon mendim paraprak Autoritetit të Konkurrencës, Komisionit të Ndihmës



Shtetërore dhe organeve të tjera të specializuara, të cilat ia përcjell Komitetit të Investimeve Strategjike (në vijim KIS).

7. Bashkëpjesëmarrja në një investim strategjik mund të propozohet nga vetë shteti, në rastin e një projekti strategjik të përgatitur nga organet shtetërore, me qëllim mbështetjen e investitorëve për realizimin e një investimi strategjik. Pjesëmarrja e shtetit në investimet strategjike, për të cilat nevojitet kryerja e procedurave konkurruese, shpallet që në fazën fillestare të tenderave ose garave që zhvillohen në këto raste.

8. Bashkëpjesëmarrja e shtetit mund të kërkohet edhe nga vetë investitorët strategjikë të cilët propozojnë realizimin e një investimi strategjik, me qëllim rritjen e nivelit të mbështetjes së projektit, uljen e riskut operacional dhe rritjen e garancive për realizimin e tij.

9. Çdo investitor, i cili kërkon pjesëmarrjen shtetërore në një investim strategjik, përveç dokumentacionit, për përfshirjen në procedurat administrative të investimeve strategjike dhe atë mbi garancitë financiare, duhet të paraqesë pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Planin e plotë të biznesit, në të cilin përcaktohen edhe detyrimet përkatëse të propozuara në ngarkim të investitorit strategjik e të shtetit, si dhe kostot përkatëse;

b) Studimin e plotë të fizibilitetit, i cili përfshin në mënyrë të detajuar analizën dhe vlerësimin teknik, ekonomik dhe tregtar të projektit, si dhe provon se projekti është i përshtatshëm, i nevojshëm dhe i realizueshëm;

c) Një relacion shpjegues, ku jepen arsyet e kërkesës për përfshirje shtetërore, mënyra e pjesëmarrjes apo mbështetjes direkte të shtetit në investim dhe një shpjegim i detajuar i vlerësimit të pjesëmarrjes shtetërore si e nevojshme nga ana e investitorit për suksesin e projektit;

ç) Përshkrimin e detajuar të formës e të nivelit të pjesëmarrjes shtetërore të kërkuar, të shoqëruar me informacione konkrete për aspektet e pjesëmarrjes shtetërore;

d) Identifikimin e asetit publik të luajtshëm ose të paluajtshëm dhe të organit administrues përgjegjës, në rastin kur kërkohet vënia në dispozicion e një aseti publik në pronësi të shtetit;

dh) Projektin e plotë zhvillimor të infrastrukturës së brendshme dhe mënyrën e lidhjes së

saj me infrastrukturën e jashtme, në rastin kur kërkohet mbështetja me infrastrukturë mbështetëse;

e) Të drejta të posaçme që i ofrohen shtetit nga ana e investitorit në kuadër të pjesëmarrjes shtetërore në investim, të tilla si, por pa u kufizuar në:

i) vendimmarrje me të drejtë vetoje apo me shumicë të kualifikuar në shoqërinë apo partneritetin që propozohet të krijohet;

ii) të drejta të posaçme, përtej atyre të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për të emëruar anëtarë të organeve drejtuese, auditorë apo për të marrë informacion për mbarëvajtjen e investimit;

iii) të drejta të posaçme në ndarjen e dividendit, të të ardhurave të realizuara apo të çdo përfitimi të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë në favor të shtetit;

iv) opsionin e daljes së shtetit nga investimi me kushte të paracaktuara apo lehtësisht të vlerësueshme pas një periudhe kohe nga data e pjesëmarrjes së shtetit në investimin strategjik të propozuar;

v) kufizimet e zbatueshme në lidhje me transferimin e pjesëmarrjeve apo pjesëmarrjen e palëve të treta në investim;

vi) propozim për zgjidhjen e situatave të bllokimit të vendimmarrjes dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

10. Agjencia, nëpërmjet grupit operacional, verifikon propozimin e investitorit për përfshirjen e shtetit në investimin strategjik, si dhe të gjitha hipotezat, supozimet, zgjidhjet, treguesit, analizat dhe rezultatet e përcaktuara në dokumentet e paraqitura, në mënyrë që të përcaktojë nëse informacioni është i saktë, i zbatueshëm dhe i përshtatshëm për realizimin e investimit.

11. Për verifikimin e saktësisë së informacionit e të analizave të paraqitura, si dhe në rastet kur për propozimin e investitorit kërkohen njohuri të posaçme, që tejkalojnë njohuritë dhe ekspertizën e Agjencisë e të anëtarëve të grupit operacional, Agjencia mund t'i kërkojë investitorit propozues që të përballojë kostot për angazhimin nga ana e Agjencisë të ekspertëve të jashtëm të pavarur. Procedura e përzgjedhjes dhe e angazhimit të ekspertëve të jashtëm kryhet nga vetë Agjencia, sipas një procedure të hapur dhe transparente, pasi investitori propozues të ketë dhënë pëlqimin



me shkrim për mbulimin e kostos përkatëse.

12. Agjencia negocion me investitorin propozues një projekt të dokumenteve që do të nënshkruhen nga palët në rast miratimi të pjesëmarrjes së shtetit në investim, që, sipas rastit dhe formës së pjesëmarrjes, përfshijnë por pa u kufizuar në:

a) aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë, ku shteti do të marrë pjesë si ortak/aksionar, në të cilën duhet të përfshihen të gjitha kushtet, të drejtat dhe detyrimet e secilës palë;

b) marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet palëve, në rastet kur shteti merr pjesë në investim, nëpërmjet formave të ndryshme nga ajo e pjesëmarrjes në shoqëri.

Në përmbajtjen e secilit prej dokumenteve të sipërpërmendura duhet të reflektohen në mënyrë të qartë e të detajuar të drejtat dhe detyrimet e secilës palë pjesëmarrëse në investim, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe propozimi i investitorit.

13. Në çdo rast të shqyrtimit të një propozimi për pjesëmarrje të shtetit në një investim strategjik, Agjencia kërkon me shkrim mendimin paraprak të Ministrisë së Financave, si dhe ministrisë së linjës, që mbulon sektorin e investimit strategjik.

14. Procesi i vlerësimit i kryer nga Agjencia nuk mund të zgjatë më shumë se 30 ditë nga data e marrjes së dokumentacionit të plotësuar nga investitori propozues. Në përfundim të procesit të vlerësimit, pas miratimit nga ministri përgjegjës për ekonominë, Agjencia i përcjell KIS-së propozimin e paraqitur, dokumentacionin përkatës, mendimet e organeve të tjera shtetërore të përfshira, si dhe vlerësimin e saj për propozimin.

15. Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e përcjelljes së kërkesës nga Agjencia, KIS-ja vendos në lidhje me propozimin për pjesëmarrjen shtetërore në investimin strategjik. KIS-ja mund të vendosë të pranojë propozimin e paraqitur, ta pranojë me kushte apo ta refuzojë atë. Në çdo rast, vendimi i KIS-së i njoftohet investitorit propozues brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së tij.

16. Refuzimi i pjesëmarrjes së shtetit në investim nuk cenon përfitimin e statusit “Investim strategjik, procedurë e veçantë/e asistuar” në rast se investitori deklaron se

dëshiron të vazhdojë me kryerjen e investimit pavarësisht nga mospjesëmarrja shtetërore.

17. KIS-ja mund të vendosë që pranimi i propozimit të kushtëzohet me plotësimin e informacionit, të të dhënave apo garancive të investitorit për realizimin e investimit, si dhe me kërkesën për ndryshimin e kushteve të bashkëpunimit të propozuara, të tilla si; vlera apo lloji i kontributit, forma e pjesëmarrjes apo të drejtat dhe detyrimet kryesore të palëve në shoqërinë e përbashkët apo në marrëveshjen e propozuar të investimit. Në këto raste, KIS-ja i kthen dokumentacionin Agjencisë e cila komunikon me investitorin propozues në lidhje me kërkesat e parashtruara nga KIS-ja. Në rast se brenda një afati prej 30 ditësh nga data e njoftimit investitori propozues pranon kushtet e vendosura nga KIS-ja, Agjencia paraqet përsëri pranë KIS-së për vendimmarrje dokumentacionin e ndryshuar, ku reflektohen sugjerimet e KIS-së.

18. Në rastin kur KIS-ja vendos të pranojë propozimin, ia përcjell atë për miratim Këshillit të Ministrave.

19. Në propozimin e KIS-së duhet të tregohen forma, niveli dhe mënyrat e pjesëmarrjes shtetërore në investimin strategjik dhe ky propozim duhet të shoqërohet me një relacion në të cilin trajtohen në mënyrë të detajuar:

a) interesi publik dhe jepen arsyet për të cilat konsiderohet e nevojshme pjesëmarrja shtetërore në investim;

b) analiza ekonomike e investimit strategjik dhe e pjesëmarrjes shtetërore;

c) vlerësimi i avantazheve dhe rreziqeve të pjesëmarrjes shtetërore në investimin strategjik;

ç) niveli i pjesëmarrjes shtetërore në raport me vlerën totale të investimit;

d) shkalla e ndarjes së riskut operacional midis shtetit dhe investitorit strategjik;

dh) ndikimet mbi tregun e lirë dhe konkurrencën që sjell pjesëmarrja e shtetit në investim;

e) projekti i marrëveshjes që do të nënshkruhet ndërmjet investitorit dhe shtetit shqiptar, të përfaqësuar nga Agjencia në lidhje me kushtet, të drejtat dhe detyrimet e palëve në realizimin e pjesëmarrjes shtetërore në investimin strategjik.

20. Këshilli i Ministrave, bazuar në propozimin e KIS-së, si më sipër, përcakton me vendim, rast pas rasti, formën, nivelin dhe mënyrat e pjesëmarrjes shtetërore në një investim strategjik. Në vendimin e Këshillit të Ministrave përcaktohet edhe organi shtetëror, i cili autorizohet për lidhjen e kontratës me investitorin strategjik dhe për ndjekjen, zbatimin e monitorimin e saj.

II. KRIJIMI, FUNKSIONIMI DHE ADMINISTRIMI I FONDIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR MBËSHTETJEN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE

1. Fondi i Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS) krijohet nga pasuritë e paluajtshme shtetërore, objekte, truall, tokë bujqësore, pyll, livadhe dhe kullota, në pronësi të institucioneve qendrore apo të njësisive të qeverisjes vendore.

2. FPPMIS-ja krijohet, inventarizohet dhe administrohet nga ministria përgjegjëse për ekonominë.

3. Procedurat dhe rregullat për transferimin dhe administrimin e pronave shtetërore, pjesë të FPPMIS-së, kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për pronat e paluajtshme të shtetit. Transferimi dhe përfshirja e pronave në FPPMIS përcaktohen, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë.

4. Propozimi për përfshirjen e një pasurie të paluajtshme shtetërore, si pjesë e FPPMIS-së, mund të paraqitet nga organet qendrore apo vendore përgjegjëse, si dhe nga investitorët propozues të një investimi strategjik, nëpërmjet Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

5. Ministri përgjegjës për ekonominë konsultohet dhe u kërkon mendim paraprak organeve të qeverisjes qendrore dhe vendore, të cilat administrojnë pronat e paluajtshme shtetërore, të propozuara për t'u përfshirë në FPPMIS. Për këtë qëllim, u kërkon organeve të qeverisjes qendrore dhe vendore të japin informacion në lidhje me pasuritë e paluajtshme të propozuara, përdorimin aktual ose të planifikuar të tyre, si dhe të shprehin mendimin e tyre vlerësues në lidhje me përfshirjen e tyre ose jo në FPPMIS. Në rastet kur këto organe shprehin një mendim negativ për pronat e propozuara, si pasojë e përdorimit të tyre për

funksione ose shërbime thelbësore për publikun, ato mund të propozojnë prona alternative të administruara prej tyre për realizimin e investimeve strategjike.

6. Në çdo rast, organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, të cilat administrojnë pronat e paluajtshme shtetërore të propozuara për t'u përfshirë në FPPMIS, i përcjellin ministrit përgjegjës për ekonominë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e marrjes së kërkesës, dosjen e plotë në të cilën përfshihet i gjithë dokumentacioni kadastral i pronave, i vërtetuar nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

7. Ministri përgjegjës për ekonominë shqyrton dokumentacionin e dosjes së pasurive të paluajtshme dhe verifikon nëse këto prona janë:

- a) objekt i procedurave administrative të kthimit ose kompensimit të pronës;
- b) objekt i një procesi gjyqësor për titullin e pronësisë;
- c) objekt i procedurave administrative të legalizimit.

Për këtë qëllim, ministri përgjegjës për ekonominë bashkëpunon dhe u kërkon informacion vërtetues organeve shtetërore përkatëse, përfshirë por pa u kufizuar, Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe gjykatave kompetente.

8. Vënia në dispozicion e pronave të paluajtshme shtetërore kryhet pasi të jetë verifikuar përputhshmëria e investimeve strategjike me dokumentet e planifikimit të territorit, si dhe me planet, politikat e strategjitë sektoriale shtetërore. Në rastet kur investimet strategjike nuk përputhen me këto plane, KIS-ja, nëpërmjet Agjencisë, propozon përshtatjen e tyre me qëllim realizimin e investimit strategjik.

9. Ministri përgjegjës për ekonominë, pas kryerjes së verifikimit të dosjeve të pasurive të paluajtshme dhe pas shqyrtimit të mendimit vlerësues të shprehur nga organi shtetëror që administron pasuritë e paluajtshme, kryen një vlerësim përfundimtar oportuniteti nëse këto pasuri duhet t'i propozohen Këshillit të Ministrave për t'u përfshirë në FPPMIS.

Në rastet kur pronat e propozuara janë objekt



i procedurave të përcaktuara në pikën 7, të kreut II, të këtij vendimi, ose përdoren për funksione apo shërbime thelbësore për publikun, ministri përgjegjës për ekonominë vlerëson mundësinë e identifikimit dhe propozimit të pronave alternative për realizimin e investimeve strategjike.

Vetëm në rastet kur interesi publik për realizimin e investimeve strategjike mbizotëron mbi interesin e përdorimit aktual të këtyre pasurive, ministri përgjegjës për ekonominë i propozon Këshillit të Ministrave përfshirjen e tyre në FPPMIS, në përputhje dhe në respektim të legjislacionit përkatës në fuqi, i cili disiplinon këto raste.

10. Këshilli i Ministrave, rast pas rasti, miraton me vendim të veçantë transferimin dhe administrimin e pasurive të paluajtshme shtetërore të cilat përfshihen në FPPMIS, në përputhje me legjislacionin mbi pronat e paluajtshme të shtetit, si dhe përcakton rregullat për përballimin e shpenzimeve për krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e pasurive të paluajtshme, pjesë e FPPMIS-së.

11. Ngarkohet ministria përgjegjëse për ekonominë, që, brenda 3 (tre) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të identifikojë pronat e paluajtshme shtetërore të cilat do të përfshihen paraprakisht në FPPMIS, si dhe të përgatitë propozimet përkatëse për shqyrtim në Këshillin e Ministrave.

12. Ministria përgjegjëse për ekonominë inventarizon pronat e përfshira në FPPMIS, ia ofron ato investitorëve strategjikë, si dhe i publikon ato me qëllim informimin, mbështetjen dhe nxitjen e realizimit të investimeve strategjike.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe organet e qeverisjes qendrore dhe vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1031, datë 16.12.2015

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR FUNKSIONIMIN, KRIJIMIN, ADMINISTRIMIN DHE PËR FORMATIN, PËRMBAJTJEN E PROCEDURAT PËR SIGURINË E REGJISTRIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Regjistri i Investimeve Strategjike, në vijim “Regjistri”, është inventari publik, i cili përmban informacionin dhe bazën e të dhënave mbi investimet strategjike të cilat kryhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Regjistri krijohet, ruhet, administrohet, mirëmbahet dhe përditësohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në vijim “Agjencia”. Agjencia administron bazën e të dhënave në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim dhe në legjislacionin për administrimin e bazës të të dhënave shtetërore.

3. Agjencia administron regjistrin nëpërmjet një portali, rrjeti të publikuar në faqen e saj zyrtare ose në një faqe të posaçme interneti.

4. Regjistri mbahet në format elektronik dhe shkresor, në gjuhën shqipe dhe angleze. Dokumentet në formë shkresore ruhen dhe publikohen edhe në format elektronik të përshtatshëm. Të dhënat e regjistrit duhet të mbahen dhe të publikohen në formate të përshtatshme e të njohura për një përdorues të zakonshëm. Këto formate duhet të përshtaten me intervale të arsyeshme kohore, sipas zhvillimeve dhe programeve të reja teknologjike e informatike.

5. Regjistri përmban të dhënat parësore dhe të dhënat dytësore. Në të dhënat parësore të regjistrit përfshihen të dhënat dhe informacionet specifike, të mbledhura nga Agjencia, në funksion të investimeve strategjike. Në të dhënat dytësore përfshihen të dhënat dhe informacionet që merren nga baza të tjera të dhënash, ku ato janë parësore. Ndërveprimi ndërmjet bazave të të dhënave të



regjistrin lejohet vetëm për të dhënat parësore, ndërsa ndalohet ndërveprimi për të dhënat dytësore.

6. Dhënësit e informacionit janë subjektet e interesuara, të cilat përfshihen në procedurat e investimeve strategjike, si dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore që kanë kompetenca në këtë proces, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Gjatë fazës së mbledhjes së informacionit për qëllime të përfshirjes në regjistrë, Agjencia u bën të ditur subjekteve informacionin i cili do të jetë i hapur për publikun, duke i informuar për bazën ligjore, qëllimin e mbledhjes, bërjes publike, si dhe për pasojat e parashikuara nëse ky informacion nuk mblidhet.

7. Regjistri është publik dhe i aksesueshëm nga organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, investitorët strategjikë dhe nga publiku, sipas niveleve të aksesit dhe klasave të sigurisë të përcaktuara nga Agjencia.

8. Aksesit në informacionin e përmbajtur në regjistrë mund të kufizohet për disa informacione, duke garantuar ruajtjen dhe mospublikimin e të dhënave të tilla si: informacion konfidencial, të dhëna personale, sekret tregtar apo të dhëna që rrezikojnë konkurrencën e ndershme të subjekteve tregtare. Për këtë qëllim, investitorët duhet të përcaktojnë që në fillim në dokumentacionin e paraqitur prej tyre të dhënat për të cilat kërkojnë kufizimin e publikimit të tyre në regjistrë. Në çdo rast, në interes të transparencës dhe interesit publik, në regjistrë publikohen informacionet e përgjithshme për projektet dhe investimet strategjike, të cilat do të përfshijnë:

a) identifikimin e projekteve dhe investitorëve strategjikë të miratuar;

b) përshkrimin e përgjithshëm të projekteve e të investimeve strategjike;

c) garancitë financiare të ofruara për realizimin e tyre;

ç) statusin favorizues që u është njohur projekteve dhe investitorëve;

d) masat mbështetëse të garantuara nga shteti.

9. Agjencia merr masat për diferencimin e nivelit të aksesit në të dhënat e regjistrin duke u mundësuar organeve të qeverisjes qendrore e vendore dhe investitorëve instrumente të përshtatshme, të cilat mundësojnë nga njëra anë aksesin në regjistrë dhe nga ana tjetër garantojnë ruajtjen e të dhënave.

10. Agjencia merr masat e nevojshme për garantimin e sigurisë të të dhënave të përmbajtura në regjistrë, nëpërmjet përdorimit të instrumenteve mbrojtëse të përshtatshme.

11. Regjistri përmban të gjitha të dhënat që lidhen me procedurat e investimeve strategjike, duke filluar që nga momenti i propozimit të tyre deri në fazën përfundimtare, kur një investim strategjik do të ketë përfunduar.

12. Në veçanti, regjistri përmban informacione dhe të dhëna për:

a) projektet e identifikuara dhe të miratuara si projekte/investitorë potencialë strategjikë dhe/ose investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë;

b) statusin asistencial të projektit;

c) vendimet e Komitetit Strategjik të Investimit për projektet strategjike;

ç) marrëveshjet e mirëkuptimit ose marrëveshjet e tjera të lidhura me investitorët;

d) fazat e procedurave e të veprimeve të kryera për çdo projekt, si dhe detajimin e procedurave që duhet të përfundohen;

dh) komunikimet, kërkesat dhe përgjigjet e organeve shtetërore;

e) listën e lejeve, licencave dhe autorizimeve për secilin projekt, së bashku me statusin e pajisjes së tyre, duke identifikuar ato që janë miratuar dhe ato të cilat duhet të miratohen, identifikimin e organeve përgjegjëse, afatet përkatëse si edhe dokumentacionin e nevojshëm për secilën prej tyre;

ë) shërbimet që ofron Agjencia ndaj projekteve strategjike;

f) masat dhe programet mbështetëse që i janë garantuar një projekti;

g) vendimet, aktet dhe veprimet e organeve shtetërore të marra për një projekt strategjik;

gj) pasuritë e paluajtshme të përfshira në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike;

h) gjendjen dhe konsolidimin e tokës;

i) procedurat e shpronësimit;

j) sektorët dhe nënsektorët strategjikë;

k) zonat e përcaktuara si zona me përparësi zhvillimin;

l) të dhëna të tjera të konsideruara si të nevojshme nga Agjencia.

13. Regjistri elektronik përditësohet në mënyrë sa më të shpejtë me informacionet dhe procedurat që kryhen hap pas hapi, në çdo fazë



të projektit strategjik. Për këtë qëllim Agjencia merr masat dhe garanton regjistrimin dhe hedhjen në sistem të të dhënave të reja, brenda një afati 5-ditor, me qëllim përshpejtimin dhe mirëkoordinimin e procedurave të posaçme administrative favorizuese, lehtësuese apo përshpejtuese, të mbështetjes e të shërbimeve ndaj investitorëve.

14. Agjencia përcakton adresat dhe personat e kontaktit të cilët do të jenë përgjegjës për marrjen, transmetimin dhe regjistrimin në regjistër të çdo të dhëne apo procedure të kryer mbi projektet strategjike. Këto adresa dhe personat e kontaktit do t'u bëhen të njohur investitorëve strategjikë dhe organeve të tjera shtetërore të përfshira në procedurat për investimet strategjike. Investitorët strategjikë dhe organet shtetërore kanë detyrimin t'i transmetojnë Agjencisë informacionin për veprimet e kryera prej tyre, si edhe të përcaktojnë, gjithashtu, adresat dhe personat e kontaktit të cilët do të jenë përgjegjës për komunikimet me Agjencinë në lidhje me investimet strategjike.

15. Personeli i Agjencisë, i cili ka akses në informacionin e përmbajtur në regjistër, ka detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit, edhe në rastet e përfundimit të ushtrimit të funksionit të tij. Për këtë qëllim personeli nënshkruan një deklaratë konfidencialiteti, sipas formatit të miratuar nga titullari i Agjencisë dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

16. Agjencia merr masa për ngritjen dhe funksionimin e Regjistrimit të Investimeve Strategjike, brenda 3 (tre) muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

17. Shpenzimet e nevojshme për krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Regjistrimit të Investimeve Strategjike përballohen nga buxheti i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për Agjencinë.

18. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore, të përfshira në procedurat për investimet strategjike, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1032, datë 16.12.2015

PËR DOKUMENTIMIN E MARRËVESHJEVE TË INVESTITORËVE STRATEGJIKË ME PRONARËT E PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 28, të ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. MARRËVESHJET E INVESTITORËVE ME PRONARËT PRIVATE

1. Investitorët strategjikë, të cilët kanë përfituar statusin "Investim/investitor strategjik, procedure e veçantë", përpara se të kërkojnë shpronësimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga investimi strategjik, duhet të kryejnë dhe dokumentojnë procedurat për arritjen e një marrëveshjeje me pronarët, sipas përcaktimeve të këtij vendimi. Për realizimin e këtij detyrimi, investitorët u propozojnë pronarëve nënshkrimin e marrëveshjeve të posaçme, duke u ofruar atyre instrumente të përshtatshme alternative dhe/ose kompensuese.

2. Instrumentet alternative që ofrohen nga investitorët përfshijnë, pa u kufizuar:

a) mundësinë e përdorimit të përkohshëm të pasurive, pronë private;

b) mundësinë e përdorimit të pasurive, pronë private, me anë të kontratave që nuk parashikojnë kalimin e pronësisë, por përcaktojnë të drejta përdorimi ose kalimi të tilla si: qira, servitut, enfiteozë, uzufukt ose kontrata të ngjashme.

3. Në rastet kur projekti strategjik nuk mund të realizohet pa cenuar pasuritë e paluajtshme, pronë private, investitori duhet t'u ofrojë pronarëve marrëveshje për shitblerjen e pasurive, me një kompensim financiar jo më të vogël se vlera financiare e kompensimit si pasojë e shpronësimit, ose marrëveshje alternative, që ofrojnë përfitime të një natyre të ndryshme, të cilat rezultojnë të pranueshme për pronarët.

4. Për mbështetjen e realizimit të investimit strategjik, në rastet kur shteti ka marrë përsipër



angazhime konkrete për pjesëmarrjen në investim dhe kur ekzistojnë mundësitë objektive, shteti, përpara se të fillojë procedurat e shpronësimit, u ofron pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga projekti, ristrehim të përshtatshëm. Kostot e ristrehimit përllogariten si pjesë e shpenzimeve dhe e bashkëpjesëmarrjes shtetërore në investim.

II. PROCEDURAT PËR ARRITJEN E MARRËVESHJES ME PRONARËT

1. Investitori duhet të identifikojë pasuritë e paluajtshme, dhe pronarët përkatës, të cilat preken nga investimi strategjik, bazuar në të dhënat e zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

2. Investitori duhet të kontaktojë drejtpërdrejt pronarët e identifikuar, sipas dokumentacionit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, duke dakordësuar me ta datat dhe procedurat e përshtatshme për kryerjen e negociatave.

3. Në rastet kur është i pamundur kontaktimi i drejtpërdrejtë i pronarëve nga investitori, informimi i tyre bëhet nëpërmjet publikimit, për një afat 15-ditor, në median e shkruar dhe televizive, të njoftimit publik, i cili përmban informacionin për projektin strategjik, të dhënat kadastrale të zonës ku do të realizohet investimi, të dhënat e kontaktit të investitorit strategjik, të dhënat e pronarëve, sipas dokumentacionit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, dhe përcaktimin e vendndodhjes, datës dhe orarit të takimeve të posaçme me pronarët. Data për kryerjen e takimit me pronarët nuk mund të jetë më afër se 15 ditë, nga data e publikimit të parë të njoftimit. Pronarët kanë të drejtë t'i propozojnë investitorit data alternative, sipas mundësisë dhe disponibilitetit të tyre, brenda një afati 15-ditor, nga data e kontaktimit ose nga data e publikimit të parë të njoftimit.

4. Në takimet dhe negociatat që investitori kryen me pronarët, investitori u ofron atyre të gjithë informacionin e nevojshëm mbi projektin dhe u propozon marrëveshjen përkatëse, në të cilën përcaktohen instrumentet alternative ose kompensimi i përshtatshëm.

5. Investitori organizon konsultime e takime paraprake për diskutimin e kushteve të marrëveshjeve me pronarët. Afati për përmbylljen e negociatave nuk mund të jetë më i vogël se 30 ditë, nga data e takimit të parë, por, gjithsesi, jo më shumë se 60 ditë, nga kjo datë.

6. Në takimet e kryera mbahet procesverbali përkatës, në të cilin shënohen pjesëmarrësit, propozimet, kushtet e marrëveshjeve, diskutimet dhe arritja ose jo e marrëveshjeve përkatëse.

7. Për arritjen e marrëveshjes me pronarët, investitorët strategjikë kanë të drejtë t'i kërkojnë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve asistencë dhe mbështetje në lidhje me:

a) mbledhjen e informacionit nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

b) praninë e përfaqësuesve të agjencisë në takimet dhe konsultimet paraprake;

c) informacionin paraprak për vlerën e pasurive të paluajtshme.

Agjencia mbështet investitorët strategjikë me të gjithë informacionin dhe të dhënat e kërkuara prej tyre, nëpërmjet asistencës ndërinstitucionale me organet përkatëse, dhe merr pjesë në takimet e investitorëve me pronarët, në rastet kur i kërkohet.

8. Agjencia monitoron respektimin, nga ana e investitorit, të procedurave për arritjen e marrëveshjeve me pronarët, duke verifikuar informacionin dhe dokumentet e paraqitura nga investitori për këtë procedurë.

9. Vetëm në rastet kur investitori ka dokumentuar kryerjen e të gjitha procedurave për arritjen e marrëveshjeve me pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe pas një afati prej 90 ditësh, nga data e takimit të parë, nuk është arritur marrëveshja me pronarët, investitori strategjik mund të kërkojë shpronësimin, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga legjislacioni shqiptar mbi shpronësimet.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM

Nr. 1033, datë 16.12.2015

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË
SË PËRCAKTIMIT TË TARIFAVE FIKSE
TË ENERGJISË, QË DO T'U PAGUHEN
PRODHUESVE TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15, pika 1, e 27, pika 2, të ligjit nr. 138/2013, “Për burimet e energjisë së rinovueshme”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Metodologjia e përcaktimit të tarifave fikse të energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet, është, si më poshtë vijon:

“Çmimi i shitjes (lekë/kWh) = Çmimi mesatar i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent /kWh X koeficientin 1.24 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.

- Me çmim mesatar të vitit përkatës të bursës hungareze HUPX të energjisë elektrike kuptohet:

Çmimi vjetor mesatar i ponderuar, final i shlyerjes (final settlement price) së energjisë elektrike në bazë (baseload), i produkteve të livruara në segmentin e kontratave fizike të së ardhmes (Physical Futures – PhF) të bursës së Hungarisë HUPX, ashtu siç publikohet në raportin vjetor (Physical Futures Annual Report) të këtij segmenti, për vitin përkatës.

- Koeficienti 1.24 do të llogaritet për përcaktimin e çmimit të energjisë së prodhuar nga hidrocentralet dhe merr në konsideratë:

i) reduktimin e humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, si pasojë e furnizimit të energjisë elektrike në pikat e lidhjes së këtyre hidrocentraleve me rrjetin energjetik të tensionit të lartë dhe/ose të mesëm;

ii) kostot e shmangura të transmetimit të energjisë nga importi;

iii) kostot e alokimit të kapaciteteve të interkoneksionit;

iv) nxitjen e shfrytëzimit të burimeve të rinovueshme deri në arritjen e objektivave të detyrueshëm kombëtarë për pjesën e energjisë së përdorur nga burime të rinovueshme të energjisë në konsumin përfundimtar bruto të energjisë, në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë.

- Me normë mesatare të shkëmbimit euro/lekë të vitit të fundit kuptohet kursi mesatar vjetor i këmbimit nga euro/lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin përkatës.”.

2. Deri në miratimin e çmimit të shitjes së energjisë së prodhuar nga prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike sipas këtij vendimi për vitin 2016, ERE merr masa që të përcaktojë një çmim që do të aplikohet për një periudhë të ndërmjetme, në zbatim të vendimit nr. 125, datë 11.2.2015, të Këshillit të Ministrave. Diferencat që mund të rezultojnë, ndërmjet çmimit të miratuar për vitin 2016 dhe çmimit të miratuar për periudhën e ndërmjetme, do të sistemohen nëpërmjet korrigjimit të faturimeve përkatëse.

3. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 280 lekë